Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, gusht 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Liburn Aliu, Ministër

Adresa: Ndërtesa e Gërmisë Rr. Nënë Terezë, Aneksi i ri, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës (MI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Regjistrimi i shpenzimeve të realizuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (vlera 663,607€) si dhe mosregjistrimi i disa pagesave nga kategoria e investimeve kapitale (vlera 489,306€) në regjistrin kontabël të pasurive, ka rezultuar me regjistër të pasaktë dhe jo të plotë të pasurive.

A1 Regjistrimi i pasurive si investim në vijim edhe pse për të njëjtat kishte përfunduar procesi i investimit dhe gjithashtu mos kalimi i pronësisë në komuna për projektet me bashkëfinancim kanë ndikuar në mbivlerësimin e pasurive për 41,756,904€.

A2 Shpenzimet e mirëmbajtjes së rrugëve që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve por të paguara nga kategoria e investimeve kapitale, ishin regjistruar në regjistrin kapital të pasurive si investime në vijim duke mbivlerësuar vlerën e pasurive për 67,235,887€.

A3 Nën vlerësimi i vlerës së automjeteve zyrtare si rezultat i mos regjistrimit të tyre në regjistrat e pasurisë ka ndikuar që pasuria të mos prezantohet saktë në RVF për vlerën 187,669€.

A4 Klasifikimi i gabuar i pasurive ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive të prezantuara në RVF për 164,042€.

A5 Mangësitë në procesin e regjistrimit të stoqeve kanë ndikuar në prezantimin jo të saktë të vlerës së tyre në RVF për 60,000€.

A6 Vlera e prezantuar e detyrimeve kontingjente në nenin 18 në RVF- të e vitit 2020, nuk ishte e saktë për 3,670,197€.

B2 Vlera e obligimeve të papaguara e prezantuar në RVF ishte e nënvlerësuar për 33,296,163€

A7 Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në RVF ishte e mbivlerësuar për 444,409€

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Infrastrukturës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A8 Procesi i realizimit të projektit "Rehabilitimi i Rrugës R 210 Brezovicë Qendra e Skijimit Lot 2", ishte shoqëruar me disa mangësi.

A9 Mos nënshkrimi i aneks kontratave nga zyra e prokurimit(në rastet kur është paraqitur nevoja) ka shkaktuar vonesa dhe realizim të punëve të pa kontraktuara.

B3 Ishte bërë realizimi i punimeve pa kontratë.

A10 Përdorimi i kontratave jo adekuate ka shkaktuar tejkalim të vlerave të tyre.

A11 Kontratat për Projektet “Zgjerimi i rrugës Regjionale - Segmenti Komoran Morinë 17 km Lot 1”; “Mbikalimi në Polluzhë dhe Mbikalimi në Terstenik“ dhe “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – Mali Zi“ ishin përcjellë me mangësi të ndryshme duke filluar nga hartimi i projektit deri të ekzekutimi i punimeve.

B4 Pagesat për ndryshimet e sasive në pozicione të kontratave me bashkëfinancim me komuna edhe pse paraprakisht nuk ishte dhënë pëlqimi nga ministria për këto ndryshime.

C2 Pagesat për të punësuarit me Marrëveshje të Brukselit edhe pse të njëjtit nuk kishin realizuar asnjë aktivitet në ministri siç parashihet me aktemërimet përkatëse.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Me datë 20.10.2020, ZKF përmes Sekretarit të Përgjithshëm kishte njoftuar Departamentin e Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në kuadër të Policisë së Kosovës, se nga llogaritë e projekteve kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës përmes 4 pagesave të realizuara në llogarinë e një OE me datë 09.10.2020, ishte tërhequr shuma 2,077,960€ pa autorizimin e zyrtarëve të Ministrisë. Informata në lidhje me ketë rast është shpalosur në shënimin nr 6 në RVF-të e Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2020.Në momentin kur e kemi përfunduar auditimin, rasti ka qenë duke u trajtuar nga organet kompetente. Deri më tani kjo shumë nuk i është kthyer Buxhetit të Kosovës.

2 Nga testimi i mostrave kemi vërejtur se, Ministria për vitin 2020 kishte kryer pagesa nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë prej 1,527,692€, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ishin të buxhetuara me ligjin e buxhetit si investime kapitale.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të këtyre çështjeve

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Infrastrukturës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Infrastrukturës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Infrastrukturës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikun 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike[4]



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale (vlera individuale mbi 1,000€ dhe afati i përdorimit më shumë se një vit), pasuritë jo kapitale (vlera individuale më e vogël se 1,000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit) dhe stoqet. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Vlera e pasurive (1,592,171,944€), e prezantuar në RVF në nenin 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se:

- Dy pagesa në vlerë 663,607€ të realizuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për mirëmbajtje të urave ishin regjistruar në regjistrin e pasurive si investime në vijim pa plotësuar kushtin për pasuri kapitale. Ndërsa një pagesë në vlerë 83,333€ e realizuar nga investimet kapitale për të njëjtin shërbim ishte regjistruar dy herë në regjistrin e pasurive.
- Pagesa në vlerë 479,940€ e datës 25.12.2019 për projektin "Zgjerimi i rrugës regjionale R107 qendrore në Deçan" nuk ishte regjistruar në SIMFK.
- Gjithashtu, tri pajisje në vlerë 9,366€ të cilat i takonin pasurive kapitale mbi 1,000€ nuk ishin regjistruar në SIMFK sipas kërkesave ligjore.

Mos regjistrimi i pasurive në SIMFK ka ndodhur si pasojë e mos qarkullimit të dokumentacionit mes zyrtarëve të pagesave dhe pasurisë. Ndërsa regjistrimi i gabuar i pasurive kishte ndodhur për shkak të mos analizimit të përmbajtjes së faturave nga zyrtarët relevant. Duhet theksuar se pozitën e zyrtarit të pasurisë ministria e kishte mbuluar me zyrtar të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta deri në muajin nëntor 2020. Ndërsa nga ajo periudhë kjo pozitë është e pa plotësuar.

Ndikimi

Regjistri jo adekuat i pasurive në SIMFK ndikon që vlera e pasurive e prezantuar në RVF të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B1

Ministri të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar regjistrimin e saktë dhe të plotë të të gjitha pasurive kapitale në pajtim me kërkesat ligjore. Në një periudhë sa me të shpejtë, duhet të plotësohet pozita e zyrtarit të pasurive dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mos aplikimi i zhvlerësimit për pasuritë në përdorim dhe mos largimi i pasurive nga regjistri të cilat duhej të kalonin në pronësi të komunave

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim". Ndërsa pika 3 e këtij neni parasheh që "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Me tutje neni 22 paragrafi 4.4 përcakton se "Norma e zhvlerësimit për ndërtimin e rrugëve është 20 vite".

Edhe pse kishte përfunduar procesi i investimit të disa projekteve dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre, në regjistrin e SIMFK-së ato akoma figurojnë si investime në vijim. Projektet të cilat do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim janë:

- Autostrada Prishtinë- Hani i Elezit, pranimi teknik ishte bërë me 29.05.2019, ndërsa pagesat akoma janë të regjistruara si investime në vijim në vlerë totale 520,458,672€. Si rezultat i kësaj, vlera e këtij projekti është mbivlerësuar për 39,034,400€ për shkak të mos aplikimit të zhvlerësimit nga momenti i përfundimit të fazës së ndërtimit të këtij projekti.
- Projekti Zgjerimi i rrugëve Brahim Ademi dhe Driton Islami – pranimi teknik ishte bërë me datë 28.06.2019 në vlerë 3,718,937€, ndërsa vlera e nënvlerësuar e zhvlerësimit ishte 278,920€.
- Zgjerimi i rrugës rajonale R102 Segmenti Projekti Komoran- Morinë Llot 2- pranimi teknik ishte bërë me datë 15.11.2019 në vlerë 3,427,339€. Vlera e regjistruar në regjistrin e pasurive ishte 3,276,723€, ndërsa vlera e nënvlerësuar e zhvlerësimit ishte 163,836€.
- Rikonstruktimi i rrugës lokale Hogosht-Lisock, pranimi teknik ishte bërë me datë 13.11.2015 në vlerë 1,020,076€. Vlera e këtij projekti e regjistruar në regjistrin e pasurive ishte 749,993€.Zhvlerësimi ishte nënvlerësuar për vlerën e regjistruar 187,483€.
- Shtresimi me Asfalt në rrugën Hajgobillë, pranimi teknik ishte bërë me datë 30.09.2019 në vlerë 1,046,201€, ndërsa vlera e nënvlerësuar e zhvlerësimit ishte 61,028€.
- Ndërtimi i rrugës Vojnik-Osjan Lot 2 pranimi teknik ishte bërë me 19.11.2018 në vlerë 997,884€, ndërsa vlera e nënvlerësuar e zhvlerësimit ishte 99,788€.
- Asfaltimi i rrugëve në lagjen Luzha në fshatin Begrac,-Kaçanik, pranimi teknik ishte bërë me datë 05.11.2018 (vlera 380,950€). Zhvlerësimi ishte nënvlerësuar për 38,095€.
- Projekti Ndërtimi i rrugës Demjan-Pnish, Gjakovë, pranimi teknik ishte bërë me 11.10.2018 në vlerë 395,372€ ndërsa vlera e nënvlerësuar e zhvlerësimit ishte 41,185€.

Me tutje, neni 13 i kësaj rregulloreje përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta

regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj".
Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës. Ne kemi evidentuar që ministria nuk kishte mbyllur llogarinë e investimeve në vijim për disa projekte të testuara edhe pse për të njëjtat ishte bërë pranimi teknik i punëve.

- Në vitet 2017 dhe 2018, Komuna e Istogut kishte bërë pranimin teknik të 5 projekteve në vlerë 866,720€, të cilat janë financuar nga ministria[5]. Këto projekte nuk janë larguar nga regjistri i pasurive të ministrisë.
- Raste të njëjta janë edhe dy projekte të përfunduara për Komunën e Kaçanikut në vlerë 314,354€, Ndërtimi i urës mbi lumin Morava në Komunën e Vitisë (pranimi teknik me datë 08.10.2019, vlera 219,904€), si dhe Ndërtim i i rrugës në fshatin Stan Tërg në Komunën e Mitrovicës (pranimi teknik me 27.12.2019, vlera 451,191€).

Shkak për mangësitë e identifikuara ishte mungesa e bashkëpunimit në mes të zyrtares së pasurive dhe zyrtarëve të pagesave me departamentin e menaxhimit të rrugëve, si dhe mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme lidhur me procesin e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi

Mbajtja e pasurive kapitale si investime në vijim, përkundër faktit që ato plotësonin kriterin për tu klasifikuar si pasuri në përdorim si dhe mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat ashtu siç parashihet me rregullore, ka shkaktuar mbivlerësimin e pasurive kapitale të prezantuara në nenin 19.3.1 të RVF.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Shpenzimet e mirëmbajtjes së rrugëve ishin regjistruar si investime në vijim duke mbivlerësuar regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja

Neni 15 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare tek Organizatat Buxhetore thekson se "Kostoja e mirëmbajtjes së pasurive kapitale nuk konsiderohet përmirësim dhe si e tillë, nuk regjistrohet si shpenzim kapital''. Po ashtu, neni 7 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ 04/2019 -Për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve Kapitale përcakton se "Shpenzimi pasues në përsëritjen e aktivitetit/procesit të projektit ose korrigjimin e aktivitetit, i cili nuk siguron përfitim ekonomik në të ardhmen përtej atij që ndërlidhet me shpenzimin origjinal, trajtohet si shpenzim rrjedhës".

Në regjistrin e pasurive jo financiare kapitale të ministrisë janë të regjistruara si investime në vijim pagesat e realizuara për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në vlerë 67,235,887€ (të gjitha pagesat e regjistruara nga viti 2015 deri në fund të vitit 2020) edhe pse ato nuk e plotësojnë kushtin sipas kërkesave rregullative për tu trajtuar si pasuri respektivisht investime në vijim. Vetëm në vitin 2020 vlera e pagesave të regjistruara në regjistrin e pasurive kapitale për këto shërbime ishte 12,012,259€.

Regjistrimi i këtyre pagesave në regjistrin e pasurive kishte ndodhur për faktin se realizimi i shpenzimit kishte ndodhur nga kategoria e investimeve kapitale.

Ndikimi Regjistrimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së rrugëve si investime në vijim pa plotësuar kushtin ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive kapitale të prezantuara në RVF.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të pasurive (sidomos vlerave të regjistruara të shpenzimeve të mirëmbajtjes) në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e identifikuara dhe të prezantohet saktë vlera e pasurive në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mosazhurnimi i regjistrit të automjeteve

Gjetja Neni 9 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizata Buxhetore përcakton se " Tjetërsimi i pasurive mund të ndodh me rastin e shitjes, transferit në një organizatat buxhetore, dhënies në formë të dhurimit dhe asgjësimit". Po ashtu pika 10 e këtij neni përcakton se për të gjitha vendimet e marra, Komisioni për Tjetërsimin e Pasurisë jo Financiare do të njoftojë Zyrtarin e Pasurive dhe do t'i dorëzojë një kopje të të gjithë dokumentacionit lidhur me procesin e tjetërsimit".

Ne kemi vërejtur se tetë (8) automjete të cilat në vitin 2019 ishin shitur përmes procesit të ankandit publik nga MAP, ende figurojnë në regjistrin kontabël të pasurive.

Për më tepër neni 8 i rregullores për menaxhimin e pasurive përcakton "Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga organizatat tjera buxhetore".

Sipas kontratës së noterizuar me datën 06.11.2020 Operatori Ekonomik i kontraktuar nga MI për projektin Ndërtimi i rrugës Mitrovicë-Milloshevë M2 kishte kaluar në pronësi të ministrisë 4 automjete Ford Kunga në vlerë 134,012€. Këto automjete ministria nuk i kishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive si dhe

Dy vetura KIA Sportage të blera nga ministria me datë 08.04.2019 në vlerë 53,657€, nuk ishin regjistruar fare në regjistrin e pasurive në SIMFK.

Shkak i mos azhurnimit të regjistrit të pasurive për vitin 2019 ishte pakujdesia e zyrtarit përkatës të pasurive dhe mos mbikëqyrja adekuate e menaxhmentit ndaj zyrtarëve përgjegjës. Ndërsa shkak i mos regjistrimit të automjeteve të pranuara në vitin 2020 ishte mungesa e zyrtarit të pasurive.

Ndikimi Mos regjistrimi/largimi i automjeteve nga regjistri kontabël i pasurive ka shkaktuar prezantim jo të saktë të pasurive që janë në pronësi të MI-së.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive duke larguar automjetet të cilat nuk janë pronë e ministrisë dhe duke regjistruar ato të cilat janë në pronësi të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Regjistrimi i pasurive në klasa të gabuara duke mundësuar aplikimin e normave të gabuara të zhvlerësimit

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, parasheh se: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuar në bazë të planit kontabël”. Po ashtu, neni 22 thekson se: “Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit”. Ky nen i rregullores përcakton edhe normat e zhvlerësimit për secilin kategori të pasurive.

Në regjistrin e pasurive në SIMFK, katër (4) pagesa të regjistruara në vitin 2006 “Rehabilitimi i rrugëve Kamenicë Tushec” ishin regjistruar në klasën e pasurive "*Struktura tjera"* ku norma e zhvlerësimit është 40 vite dhe jo në klasën "*Ndërtimi i Rrugëve"* me normë të zhvlerësimit 20 vite, siç përcaktohet me rregulloren e pasurive. Si rezultat i kësaj këto pasuri janë të mbivlerësuara për 135,531€ për shkak të përcaktimit të gabuar të normës së zhvlerësimit.

Gjithashtu, një pajisje "*Set i GPS dhe Smart Rover Real Time"*, ishte regjistruar në vitin 2009 në klasën ndërtimi i rrugëve me normë të zhvlerësimit 20 vite, ndërsa do të duhej të regjistrohej në klasën e pajisjeve tjera me normë të zhvlerësimit 6 vite. Vlera e mbivlerësuar e kësaj pajisje ishte 28,511€.

Vlen të ceket se për disa pajisje të regjistruara në vitin 2019 (pasuri nën 1,000€) nuk ishte bërë llogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit nga sistemi e-pasuria.

Ndikimi Regjistrimi në klasa jo adekuate ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive të prezantuara në RVF për 164,042€.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që regjistrit të pasurive t'i bëhet një rishikim i detajuar në mënyrë që të eliminohen mangësitë të cilat janë prezente në fushën e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Regjistër jo i saktë i stoqeve

Gjetja Neni 3 i Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare në OB përkufizon se "stoqet nënkupton pasurinë jo financiare e cila mbahet si pajisje rezervë apo material zyre e cila nuk është shpërndarë te personeli për përdorim. Po ashtu, nenit 6.3 Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Vlera e stoqeve prej 105,349€ e prezantuar në nenin 19.3.3 të RVF-së nuk ishte e saktë, kjo për faktin se në kuadër të stoqeve ishte e regjistruar një pajisje "GPS për matje gjeodezike" në vlerë 60,000€. Kjo pajisje ishte e regjistruar edhe në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK në vlerë të mbetur 28,511€.

Kjo gjendje është rezultat i mirëmbajtjes së dobët të sistemit e-pasuria dhe gjithashtu mos azhurnimit të regjistrave nga zyrtarët kompetent.

Ndikimi Prezantimi i pasurive të njëjta në dy regjistra të pasurive kishte ndikuar në mbivlerësimin e stoqeve për 60,000€.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e ministrisë janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive. Po ashtu, duhet të siguroj që vlera e stoqeve të prezantohet drejt në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Raportim jo i saktë i detyrimeve kontingjente në RVF

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Detyrimet kontingjente (18,987,471€) të prezantuara në nenin 18 në RVF për vitin 2020, nuk ishin të sakta, për arsyet në vijim:

- Përmes propozimit për ekzekutim të datës 24.02.2012, një OE kishte kërkuar nga Gjykata që t'i ekzekutohet pagesa në vlerë 33,800€ për shërbimin e transportit të banorëve shqiptar të Kodrës së Minatorëve-Mitrovicë, dhe në vitin 2016 gjykata nxjerrë vendim duke aprovuar kërkesën e tij. Në raportin e detyrimeve kontingjente ky borxh ishte regjistruar 3,380,000€ duke mbivlerësuar vlerën e detyrimeve kontingjente për 3,346,200€.
- Në bazë të vendimit të përmbaruesit, Thesari në datat 23 dhe 24 dhjetor 2020 kishte ekzekutuar pagesat ndaj një OE në vlerë 87,031€, mirëpo të njëjtën vlerë ministria nuk e kishte larguar nga raporti i detyrimeve kontingjente.
- Për katër raste në vlerë 236,966€, të shpalosura si detyrime kontingjente, ministria nuk kishte ndonjë dokument që dëshmon vërtetësinë e këtyre detyrimeve.

PParaqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe pa mjaftueshmërisë së kontrollit të brendshëm gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontingjente në RVF.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Raportim jo i drejtë i obligimeve në RVF

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Vlera e prezantuar në nenin 17 të RVF-së (Raport për detyrimet e papaguara) ishte 33,680.80€, ndërsa në shpalosjet e bashkangjitura në RVF, vlera e detyrimeve të papaguara ishte 33,344,487€. Vlera e prezantuar në nenin 17 të RVF-së krahasuar me shpalosjet ishte nënvlerësuar për 33,310,856€ [6].

Përveç kësaj, ne kemi identifikuar se një faturë ishte prezantuar si obligim i papaguar në vlerën e saj totale (vlera 90,150€) edhe pse nga kjo faturë ishin bërë 14,571€ pagesë.

Po ashtu, fatura e datës 24.04.2020 me nr 011/2020 në vlerë 130,000€ ishte paguar pjesërisht ndërkohë që nuk ishte raportuar pjesa e mbetur e obligimit në vlerë prej 9,909€.

Ndërsa për një obligim të prezantuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në vlerë 10,031€, ministria nuk ka ofruar dëshmitë burimore.

Këto parregullsi vijnë kryesisht për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme tek departamenti i financave.

Ndikimi Kontrollet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme në RVF

Gjetja Neni 16 i rregullores 01/2017 Për raportim vjetor nga Organizata Buxhetore përcakton ”Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”.

Ne kemi vërejtur se vlera e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në nenin 16 të RVF- së nuk ishte pasqyruar në mënyrë të saktë. Vlera në RVF ishte 3,269,824€, ndërsa në raportin analitik të dërguar nga zyrtarët përkatës ishte 2,825,415€. Rrjedhimisht, vlera e mbivlerësuar ishte 444,409€.

Shkak i prezantimit jo të saktë të vlerës së llogarive të arkëtueshme ishte pakujdesia e Zyrtarit Kryesor Financiar me rastin e përgatitjes së RVF-së.

Ndikimi Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon RVF të mos prezantojë pamje të drejtë dhe krijon paqartësi tek përdoruesit e saj.

Rekomandimi A7 Ministri duhet te siguroj se me rastin e përgatitjes së RVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A8 - Dobësi në procesin e realizimit të Projektit Rehabilitimi i Rrugës Regjionale R 115 Gërlicë e Epërme- Shterpcë- Brezovicë dhe rrugës R 210 Brezovicë Qendra e Skijimit Lot 2

Gjetja

Neni 14 i Ligjit nr. 03/L-120 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë nr 2003/1 parasheh që "Ministria dhe komuna brenda autoritetit të tyre ndërmarrin masa për ndalimin e ndërtimeve pa leje në pjesët e rrugës dhe brezin mbrojtës rrugor". Po ashtu neni 21.1 i këtij ligji parasheh se "Personi juridik ose fizik bënë kundërvajtje nëse pa arsye dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji: a) Bllokon një rrugë publike ose vendos ndonjë material në rrugë publike; ose b) Pengon, ndërprenë, shkurton ose në mënyrë tjetër dëmton rrugën publike. Përveç tjerash ky ligj gjithashtu parasheh (neni 26.1) se në hapësirën e përcaktuar për Brez mbrojtës rrugor askush nuk mund të hapë minierë, ndërtohen liqej artificial, fabrika dhe instalime të ngjashme që mund t'i dëmtoj rrugët publike, brenda një distance prej: a) 60 metra nga rrugët magjistrale; b) 40 metra nga rrugët regjionale; dhe c) 30 metra nga rrugët lokale.

Për projektin Rehabilitimi i Rrugës Regjionale R 115 Gërlicë e Epërme- Shterpcë- Brezovicë dhe rruga R 210 Brezovicë-Qendra e Skijimit Lot 2, ministria ka nënshkruar kontratë (dt 18.04.2019) me OE në vlerë 1,956,340€ dhe aneks kontratë për të njëjtin projekt (dt.17.12.2019) në vlerë 193,446€. Bazuar në kushtet e veçanta të kontratës ky projekt duhej të realizohej për 220 ditë. Gjatë rishikimit të pagesave të realizuara në vitin 2020 dhe ekzaminimit fizik, kemi vërejtur që edhe pse ishin realizuar rreth 89% të pagesave në rrugën R210 Brezovicë - Qendra e Skijimit, e njëjta ishte pothuajse e tera e dëmtuar për arsyet si në vijim:

Edhe pse punët për rehabilitimin e kësaj rruge kishin filluar, në kërkesën e datës 13.08.2019 të nënshkruar në emër të ministrit i kërkohet komisionit të formuar të shqyrtojë me prioritet kërkesën e një subjekti privat për dhënien e pëlqimit për shtrirjen e gypit përgjatë rrugës rajonale me qëllim të ndërtimit te hidrocentraleve gjeneruese dhe pajimet tjera përcjellëse. Përkundër kësaj, subjekti privat kishte filluar punimet dhe kishte bërë gërmimin e rrugës me ekskavator me qëllime të vendosjes së gypave fi500 pa dhënien e pëlqimit nga ministria siç parashihet me ligjin për rrugët (neni 27) duke dëmtuar trupin e rrugës. Inspektorati i Infrastrukturës rrugore kishte dorëzuar kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Ferizaj (dt 16.12.2019) për subjektin privat për shkak të realizimit të punëve pa pëlqim nga ministria, mirëpo përkundër kësaj ZKA me datë 10.02.2020 lëshon vendim për dhënien e pëlqimit subjektit privat për vazhdimin e projektit në bazë të kërkesës së parashtruar.

Edhe pse ZKA kishte dhënë leje subjektit në fjalë, ministria nuk kishte ndërprerë punimet në projektin Rehabilitimi i Rrugës Regjionale R210 Brezovicë-Qendra e Skijimit deri në muajin maj 2020[9]. Si rezultat i kësaj subjekti privat kishte vazhduar edhe me gërmimin e asaj pjese të rrugës të cilën ministria e kishte asfaltuar në vitet 2019-2020.

Tutje, Udhëzimi Administrativ (MI) nr 08/2017 për ndryshimin dhe

plotësimin e udhëzimit administrativ nr.09/2015 për kyçje, instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale në nenin 11 parasheh që "Mbikëqyrja e punimeve gjatë vendosjes së instalimeve bëhet nga menaxheri për mirëmbajtje regjionale varësisht prej rrugës në të cilën vendosen instalimet".

Në vendimin për dhënien e pëlqimit, ZKA kishte përcaktuar personin përgjegjës nga ministria për mbikëqyrjen e punimeve të realizuara nga subjekti privat. I njëjti përmes shkresës zyrtare (dt 10.11.2020), njofton sekretarin se deri me datë 29.09.2020 nuk ka qenë i informuar lidhur me përcaktimin e tij në rolin e mbikëqyrësit të subjektit në fjalë. Sipas këtij njoftimi, deri në atë periudhë punët nga subjekti privat ishin realizuar në masë të madhe pa mbikëqyrjeje nga ana e tij dhe për të cilat ai nuk do të bartë përgjegjësi.

Ndërsa neni 23 i udhëzimit nr 09/2015 – Kthimi në gjendjen e mëparshme thotë se pas kryerjes së punimeve ,segmenti rrugor ku zhvillohen punimet duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Në rast të dëmtimit të rrugës, brezit rrugor ose objektit në rrugën nacionale apo rajonale nga personi i cili e vendos instalimin, i njëjti obligohet ta sanoj dëmin e shkaktuar nga gjatë apo vendosjes se instalimit. Po ashtu, neni 9 përcakton se nëse poseduesi i pëlqimit nuk përfundon ndërtimin e kyçjes në afatin prej 12 muajsh nga dita e marrjes se pëlqimit konsiderohet së ka hequr dorë nga kyçja dhe pëlqimi shfuqizohet automatikisht.

Gjatë ekzaminimit fizik (25.05.2021) ne kemi vërejtur që kjo rrugë ishte shumë e dëmtuar, në disa pjese vështirë e kalueshme dhe sanimet e parapara që të realizohen nga subjekti privat akoma nuk kishin ndodhur.

Mos finalizimi i projektit për rehabilitimin e rrugës duke pasur për pasojë edhe dëmtimet e mëtutjeshme të saj, kishte ndodhur për shkak të marrjes së vendimeve nga menaxhmenti duke mos u koordinuar me drejtoritë tjera relevante dhe duke mos njoftuar tutje personat të cilët ishin ngarkuar me përgjegjësi për menaxhimin e projekteve përkatëse.

Ndikimi

Vazhdimi i asfaltimit të rrugëve, edhe përkundër dhënies së pëlqimeve të palëve tjera për instalime të ndryshme ka ndikuar që mjetet të shpenzohen pa arritjen e qëllime të përcaktuara për këtë projekt. Gjithashtu, mos sanimi i dëmtimeve brenda afatit të paraparë ligjor nga subjekti privat rrezikon që rruga të dëmtohet tutje dhe të mos mund të finalizohet me mjetet e njëjta të parapara me kontratë.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të siguroj që, kërkesat e ndryshme të palëve të treta të trajtohen në kohë sipas rregullativës ligjore në mënyrë që vendimet përkatëse të mos kenë implikim negativ në projektet e ministrisë. Tutje, duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke siguruar komunikim të mirëfilltë në mes të drejtorive kyçe dhe duke siguruar informim të saktë dhe në kohë të personave që janë përcaktuar në menaxhimin e projekteve të ministrisë. Ministri, duhet të sigurohet që rruga e dëmtuar të kthehet sa më shpejtë në gjendjen e mëparshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Mos nënshkrimi i aneks kontratave nga zyra e prokurimit duke shkaktuar vonesa dhe realizimin e punëve të pa kontraktuara.

Gjetja

Sipas rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik pika 61.22 thekson se ''Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit pas aprovimit nga ZKA".

- Tek projekti '' Ndërtimi i Autoudhës : Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë – Segmenti: Banullë – Bresalc l=22.31 km Lot 3 '' vlera e kontratës 6,850,467€, pas pranimit të kërkesës së menaxherit të kontratës për punë shtesë si pasoj e mospërputhjes së projektit me gjendjen faktike në teren, njësia për zbatimin e projektit kishte aprovuar kërkesën e menaxherit duke vlerësuar se punët shtesë të nevojshme ishin në vlerë 614,752€. Edhe pse raportin e vlerësimit të aprovuar nga ZKA, komisioni e kishte dërguar tek zyra e prokurimit me datë 24.12.2019, ndryshimet nuk ishin bërë dhe si rezultat nuk ishte nënshkruar aneks kontrata. Sipas informatave të dhëna nga menaxheri i kontratës me datë 24.05.2021 akoma nuk ishte bërë nënshkrimi i aneks kontratës dhe e njëjta ishte në proces të nënshkrimit. Në pagesën në vlerë 436,471€ kemi konstatuar se përmbajnë sasi të pozicioneve të cilat ishin planifikuar të shtoheshin në kërkesën për punë shtesë dhe për të njëjtat nuk ishte nënshkruar aneks kontrata. Vlera e realizuar e këtyre pozicioneve pa nënshkrim të aneks kontratës ishte 64,739€.
- Tek Projekti "Zgjerimi i Rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës (Veternik) Ura dhe Zgjidhja e Nyjës që lidhë rrugën nacionale N2 dhe N25.2 dhe kyqjen e Autostradës R7" (vlera 2,504,150€), ishte paraqitur nevojave e punëve shtesë për asfaltimin e rrugëve alternative të cilat duhej të përdoreshin për kalimin e automjeteve gjatë periudhës së punimeve, të cilat nuk ishin të parapara me projekt. Edhe pse kërkesa e aprovuar nga komisioni i formuar dhe nga ZKA ishte dorëzuar, zyra e prokurimit as në vitin 2020 nuk kishte nënshkruar aneks kontratën. Për këtë projekt ishte bërë pranimi teknik i pjesshëm (dt 29.12.2020), ndërsa disa aktivitete tjera ishin ndërprerë deri në nënshkrimin e aneks kontratës. Sasitë e pozicioneve të realizuara pa aneks kontratë në situacionin e tretë komulativ ishin 18,771€.
- Për projektin "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9.1 Segmenti Dollc-Gjakovë, Lot 3" (vlera 3,998,888€) në bazë të kërkesës së menaxherit të kontratës komisioni i formuar për vlerësimin e punëve shtesë (gjithnjë si pasoj e gabimeve në projekt) me datë 10.03.2020 kishte aprovuar kërkesën dhe kishte rekomanduar lidhjen e aneks kontratës në vlerë 394,631€. Zyra e prokurimit nuk kishte realizuar procesin e nënshkrimit të aneksit deri me datë 30.04.2021.

Përveç ndërrimeve të shumta të zyrtarëve përgjegjës të prokurimit në këtë ministri, nuk na është dhënë ndonjë arsye tjetër konkrete për mos nënshkrimin e kontratave për punë shtesë edhe pse ndryshimet ishin të aprovuara nga ZKA.

Ndikimi

Mos amandamentimi i kontratave nga zyra e prokurimit ka shkaktuar vonesa të shumta në realizimin e projekteve duke ndikuar edhe në mos arritjen e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të sigurojë se janë duke funksionuar kontrollet në departamentin e prokurimit dhe kërkesat të cilat i drejtohen këtij departamenti nga zyrtarët e përfshirë në procese të ndryshime të prokurimit, të trajtohen me kujdes në mënyrë që të evitohen vonesat e paarsyeshme. Për më tepër, Ministri të sigurojë evitimin e ndryshimeve të shpeshta të stafit në këtë departament për shkak të ruajtjes së konsistencës dhe për të evituar bartjen e përgjegjësisë së gabimeve të ndodhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Realizimi i punimeve pa kontratë.

Gjetja Neni 61.22 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (tutje RRUOPP) thekson se ''Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit pas aprovimit nga ZKA".

Në projektin ''Ndërtimi i Urës në zgjerimin e Rrugës Nacionale N9, segmenti : Balincë (km 2+308,17-km 2+625,00)'' në vlerë 773,485€ ishte bërë kërkesa për punë shtesë nga menaxheri i kontratës, si pasojë e ndryshimeve të kushteve të terrenit. Komisioni i emëruar nga ZKA për vlerësimin e kësaj kërkese në raportin e dorëzuar me datë 22.11.2019 kishte vlerësuar se vlera e punëve të nevojshme shtesë ishte 26,583€.

Edhe pse këto ndryshime nuk ishin aprovuar nga ZKA dhe për të njëjtat nuk ishte lidhur aneks kontrata nga zyra e prokurimit, realizimi i sasive shtesë dhe ndryshimi i pozicioneve fillestare ishte realizuar nga OE me kërkesë të menaxherit të projektit.

Tutje, OE nuk ishte pajtuar me konstatimet e komisionit duke pretenduar se vlera e punëve të realizuara shtesë ishte 79,228€. Si rezultat i kësaj, OE pas refuzimit të MI-së për pagesën e shumës së kërkuar, kërkesën për realizimin e saj e kishte bërë përmes përmbaruesve privat. Bazuar në vendimin e përmbaruesit, operatori ekonomik kishte pranuar shumën 87,031€, përfshirë këtu edhe interesin për shërbime përmbarimore.

Realizimi i punëve pa kontratë kishte ndodhur si rezultat i pakujdesisë së menaxherit të projektit për ta menaxhuar kontratën në pajtim me kërkesat ligjore.

Ndikimi Shtimi/ndryshimi i pozicioneve fillestare nga menaxheri i kontratës pa kontratë mbështetëse shkakton shpenzime shtesë për ministrinë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve nuk i anashkalojnë kërkesat ligjore dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit ZKA.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Përdorimi i kontratave jo adekuate,vlera të paqarta dhe tejkalim i pagesave për kontratat publike dhe ato kornizë.

Gjetja

Neni 9 i LPP-së përcakton se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar". Gjithashtu neni 56.11 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) parasheh që "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%)".

Me datë 02.03.2018 ministria kishte lidhur kontratë publike për projektin "Mirëmbajtja e Urave për rrugët nacionale dhe regjionale të Kosovës". Gjatë analizimit të pagesave për këtë kontratë ne kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Edhe pse njësia e kërkesës kishte hartuar sasitë indikative vjetore duke kërkuar inicimin e procedurave të prokurimit përmes një kontrate kornizë, zyra e prokurimit me datën 02.08.2017 kishte bërë njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së hapur ku në dosjen e tenderit dhe njoftim për kontratë nuk kishte specifikuar se do të aplikohet kontrata kornizë dhe nëse lejohet devijimi +/- 30%. Përveç sasive indikative, në dosje ishte prezantuar edhe paramasa me çmim për njësi (sasia 1) pa përcaktuar peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull. Si rezultat i këtij procesi të prokurimit, kontrata ishte nënshkruar për periudhë dy vjeçare me çmimin për njësi vjetore prej 4,348€ dhe vlera indikative 1,807,749€. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat ligjore, sepse në rastet e tilla kur mund të parashikohet sasia indikative kjo kontratë nuk aplikohet.

Ndër të tjera, kjo kontratë ishte e paqartë edhe për sa i përket vlerës së saj, kjo sepse përveç çmimit për njësi dhe vlerës indikative, në nenin 24 të kontratës thuhej "bazuar në deklaratën nën betim të ngarkuar në sistemin e e- prokurimit si dhe ligjin e buxhetit 06/L-020 për vitin 2018, për këtë kod ka mbështetje buxhetore 4,352,022€"[7]. Ndërsa, në deklaratën e nevojave dhe në dosjen e tenderit, vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte vetëm 500,000€.

Tutje, me datë 26.10.2020 ishte bërë pranimi teknik ku vlerësimi i punëve të kryera ishte 5,377,058€[7]. Nga kjo, pagesa të realizuara deri në fund të vitit 2020 ishin 3,536,656€ ndërsa pjesa tjetër ishte bartur si obligim në vitin 2021.

ZKF dhe Drejtori i Infrastrukturës Rrugore, kishin kërkuar sqarim nga zyra e prokurimit lidhur me definimin e vlerës së kësaj kontrate. Nga kjo e fundit, ishte dhënë sqarim se kjo kontratë është me çmim njësi me poentim për të cilën nuk vlen tavani plus/minus 30%. Këto sqarime, bien ndesh me proceduarën e prokurimit të realizuar për lidhjen e kësaj kontrate, sepse nuk ishte bërë peshimi i çmimeve. Sqarime ishin kërkuar edhe nga NJAB, i cili kishte rekomanduar që ZKA dhe ZKF të ndërmerrnin masat ligjore për

shlyerjen e borxheve ndaj OE për faktin se puna është realizuar nga OE dhe është pranuar nga menaxheri i kontratës dhe gjithashtu faturat ishin të pranuar dhe të njohura si obligime nga departamenti i financave.

Raste pothuajse të ngjashme janë edhe procedurat e prokurimit të realizuara për *"Sinjalizimin dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve në Rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës"* dhe për *"Mirëmbajten Verore dhe Dimërore të Rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës"* të cilat ishin të iniciuara në vitin 2017.

Në dosjen e tenderit për projektin *"Sinjalizimin dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve në Rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës* ishte aplikuar procedura e hapur pa dhënë informatën nëse do të aplikohet kontrata kornizë me tejkalim +-30% apo çmimi njësi me peshim. Edhe në këtë rast, në dosje figuronin paramasa e çmimit për njësi por edhe paramasa me sasi totale indikative. Vlera totale e parashikuar për këtë projekt për 8 llote ishte 2,200,000 (e prezantuar në dosje por edhe në deklaratën e nevojave), ndërsa nga kjo procedurë ishin nënshkruar 4 kontrata për 6 llote me çmim për njësi. Ne kemi analizuar pagesat për kontratën e lidhur me datë 22.03.2018 e cila përmbante 3 llote[7] për periudhë tri vjeçare. Pagesa të realizuara deri në fund të vitit 2020 për tri llotet ishin 1,189,193€.

Për projektin "*Mirëmbajta Verore dhe Dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës",* ishte aplikuar dosja e tenderit për kontratën publike kornizë shërbim me disa operator. Vlera e parashikuar për tri vite për 14 llote në dosje të tenderit por edhe në deklaratë të nevojave ishte 17,231,050€. Ngjashëm si në dy rastet e para, edhe pse ishte përcaktuar sasia indikative, kontratat ishin nënshkruar për çmim njësi pa përcaktuar peshën në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull. Testimi i mostrave tona për dy llote, vunë në dukje se vlera e realizuar për këto kontrata ishte më e lartë se vlera indikative e tyre:

- "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve rajonale dhe regjionale -Regjioni Gjilan 2", Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 1,095,095€, vlera indikative 996,211€ (bazuar në sasitë indikative të dosjes), ndërsa çmimi për njësi më të cilin ishte nënshkruar kontrata ishte 337.53€. Realizimi i kësaj kontrate deri në fund 2020 ishte 2,140,908€.
- ”Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës 2017/2018/2019, Regjioni Gjakova 1” Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 1,579,083€ vlera indikative 1,359,436€, çmimi për njësi 106.62€.Realizimi i punëve sipas menaxherit të kontratës për periudhën 2019-20 ishte 2,095,841€, ndërsa pagesa të realizuara për ketë periudhë ishin 1,630,462€ .

Vlen të përmendet se të gjitha kontratat e nënshkruara si derivat i kësaj procedure të prokurimit kishin parregullsitë e njëjta.

Mos aplikimi i duhur i procedurave nga zyra e prokurimit duke mos harmonizuar nevojat nga njësia e kërkesës me informatat e prezantuara në dosje[7], si dhe gabimet në hartimin e kontratës dhe më pas shpjegimet jo adekuate të dhëna nga kjo zyre gjatë realizimit të kontratës (tek mirëmbajtja e urave) ishin ndër shkaqet kryesore të tejkalimeve dhe parregullsive të identifikuara.

Ndikimi Nënshkrimi i kontratave të paqarta sa i përket çmimit dhe sasive, e bëjnë të vështirë menaxhimin e tyre dhe mund të shpie në tejkalimin e tyre përtej planifikimit. Derisa tejkalimi i vlerës tek kontratat publike dhe ato kornizë mund të rezultojë me mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve tjera të parapara. Tutje, prezantimi i gabuar i sasive në dosjen e tenderit mund të ketë ndikim në dëmtimin e konkurrencës, duke përfituar çmime më të larta të ofertave.

Rekomandimi A10 Ministri duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së dosjeve nga zyra e prokurimit, të ofrohen të gjitha informatat relevante për procedurën e cila do të aplikohet. Gjithashtu, zyra e prokurimit duhet të aplikoj llojin e procedurës për kontratë kornizë duke potencuar devijimin +/-30% në vlerën indikative të kontratës (në rastet kur mund të definohet sasia indikative), dhe vetëm në rastet kur sasia indikative nuk mund të definohet, atëherë të aplikohen kontrata me çmim njësi në formën që e parasheh ligji. Përpilimi i kontratave duhet të bëhet në mënyrë të atillë që të mos krijojnë konfuzion lidhur me vlerën dhe sasitë që duhen realizuar. Përveç kësaj, të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjanohen tejkalimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Dobësi në procesin e realizimit të Projekteve "Zgjerimi i rrugës Regjionale - Segmenti Komoran Morinë 17 km Lot 1" dhe "Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – Mali Zi "

Gjetja Neni 52 paragrafi 3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) parasheh: "Për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara Operatori Ekonomik (OE) i njëjtë ekzekuton shërbimet ose punët shtesë, që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10 % e vlerës së kontratës origjinale)".

- Me datë 22.03.2018 ministria kishte lidhur kontratë me një OE për projektin "Zgjerimi i rrugës Regjionale-Segmenti Komoran-Morinë 17 km Lot 1" në vlerë 3,757,037€. Gjatë realizimit të punimeve, menaxheri i projektit bazuar në disa kërkesa të komunitetit dhe ndryshimeve të paraqitura si pasojë e mos përputhjes së projektit me gjendjen faktike në terren (sidomos tek paramasa e aksit kryesor) kishte bërë kërkesë për punë shtesë. ZKA kishte formuar një komision për vlerësimin e punëve shtesë të kërkuara.

  Komisioni fillimisht kishte harmonizuar paramasën dhe parallogarinë, duke eliminuar/zvogëluar sasitë e disa pozicioneve për 155,245€ dhe duke shtuar/rritur sasitë në pozicione tjera për vlerën e njëjtë. Pozicionet e eliminuara tërësisht nga komisioni ishin në vlerë 87,902€. Pas këtij procesi ishte kalkuluar tutje vlera e punëve shtesë dhe me datë 28.10.2019 ishte nënshkruar aneks kontrata në vlerë 363,061€. Edhe pse me aneks kontratë ishin shtuar sasitë e disa pozicioneve tek pjesa e aksit kryesor, ne kemi vërejtur se këto pozicione ishin tejkaluar për 173,486€ (por pa tejkaluar vlerën e kontratës).

  Përveç kësaj, Ministria pas zhvillimit të procedurave të prokurimit kishte lidhur kontratë (dt 18.04.2019) me OE e njëjtë për projektin "Mbikalimi në Polluzhë dhe Mbikalimi në Terstenik" në vlerë 436,749€

e cila kontratë do të mundësonte realizimin e rrugëve lidhëse të parapara me kontratën “Zgjerimi i rrugës Regjionale Segmenti Komoran-Morinë 17 km Lot 1“. Kjo kontratë nuk ishte e mundur të realizohej për shkak se ministria në projekt nuk kishte planifikuar shpronësimin 11 hektarëve tokë private të nevojshme për realizimin e këtij projekti. Mos realizimi i kontratës së dytë, ka pamundësuar realizimin e disa pozicioneve të parapara në kontratën e parë. Si rrjedhojë, teprica e mjeteve të parealizuara nga kontrata e parë ishte 801,384€ dhe vlera e kontratës së dytë 436,749€. Vlera totale e parealizuar e dy kontratave ishte 1,238,132€.

Me tutje,në interpretimin e KRPP-së të dhënë në Ueb faqe të saj me datë 26.06.2020 thuhet se “Kurdo që ndryshimi i kontratës zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës me qëllim që të përfshihen më shumë sasi të furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë, konsiderohet ndryshim thelbësor dhe rrjedhimisht nuk lejohet. Kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë e vetmja alternativë është që të ndërpritet kontrata aktuale dhe të iniciohet procedurë e re e prokurimit.

Bazuar në kërkesat e qytetarëve gjendjes së terrenit dhe në kërkesat e komunës së Gllogocit, ZKA kishte formuar një komision (dt 18.06.2020) për të shqyrtuar mundësinë e zgjidhjeve tjera teknike për të përfunduar projektet në fjalë.Komisioni në bashkëpunim me kompaninë projektuese kishte përpiluar riprojektimin e këtyre projekteve duke bërë shndërrimin e mbikalimeve në rreth rrotullime dhe duke shtuar paramasat e trotuareve dhe mbikalimeve për këmbësorë. Vlera e ri projektuar ishte 1,217,231€.

- Rast i ngjashëm është edhe projekti “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – Mali Zi “ për të cilin ministria me datë 16.02.2018 kishte lidhë kontratë bazë në vlerë 4,191,313€ me të cilën parashihej që të asfaltohej rruga në gjatësi 15 km. Menaxheri i projektit pas fillimit të punimeve kishte kërkuar rihartimin e projektit me arsyetimin se projekti i kishte këto mangësi: matjet gjeodezike ishin bërë shumë të cekëta, incizimi i pamjaftueshëm i gjendjes ekzistuese dhe profilet tërthore pasqyronin terrenin e gabuar. Komisioni i formuar me vendim të ZKA-së kishte dhënë rekomandim që të rihartohet projekti duke dhëne konkluzionin që për përfundimin e projektit të rihartuar përveç mjeteve që do të shtohen me aneks kontratë (vlera 414,725€) ministria duhet të shpallë edhe një fazë tenderuese në vlerë prej 2,128,847€. Kjo për faktin se ishte aprovuar kërkesa e Komunës së Deçanit që rruga të zgjerohet edhe për një metër, dhe gjithashtu të bëhej ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe lëshesave pllakore të cilat nuk ishin paraparë në projektin e parë.

  Ministria kishte nënshkruar aneks kontratën me datë 05.10.2018, mirëpo nuk kishte vazhduar me procedurat e shpalljes së tenderit për fazën e dytë (rekomandim ky i dhënë nga komisioni).

  Kërkesa ishte përsëritur edhe një herë në muajin korrik 2019, dhe duke parë që një gjë e tillë nuk po realizohet dhe marrë parasysh që asfaltimi i rrugës në 5 kilometrat e para nuk lejohej nga Kisha Ortodokse, menaxheri kishte kërkuar që mjetet e parealizuara nga kjo pjesë e rrugës të përdoren për të mbuluar sasitë shtesë në pozicionet

e gërmimit, mureve mbrojtëse, lëshesave pllakore, etj, të cilat ishin aprovuar nga komisioni duke u përdorur për të mbuluar pozicionet e ndryshuara. Si rrjedhojë e kësaj, ishte bërë pranimi teknik i rrugës me ndryshimet e lartpërmendura, mirëpo nuk ishin arritur objektivat e parapara me kontratën bazë sepse nga 15km sa ishin kontraktuara të asfaltohen, për shkak të ndryshimeve në projekt, ishin asfaltuar vetëm 10km.

Vlen të theksohet se pavarësisht ndryshimeve thelbësore që ishin bërë në të dy projektet e lartpërmendura, Zyra e Prokurimit nuk kishte vepruar në pajtim me kërkesat ligjore.

Hartimi i projekteve në mënyrën jo të duhur, mos përfundimi i procedurave të nevojshme paraprake sidomos ato të shpronësimit (në rastin e parë) dhe mos inicimi i procedurave të tenderimit nga zyra e prokurimit sipas kërkesave ligjore, janë ndër shkaqet kryesore për mangësitë e paraqitura gjatë realizimit të këtyre kontratave.

Ndikimi Mangësitë e identifikuara mund të ndikojnë në dëmtimin e konkurrencës, në shpenzime shtesë dhe vonesa në realizimin e projektit, duke ndikuar në mos arritjen e objektivave të parapara me këto projekte.

Rekomandimi A11 Ministri duhet të sigurohet se projektet ekzekutive të hartohen në harmoni me gjendjen në terren. Inicimi i projekteve të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve për realizimin e procesit të shpronësimit. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Ndryshimet në sasi pa kërkuar pëlqimin e Ministrisë

Gjetja Neni 7 i memorandumeve të mirëkuptimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përkatëse, përcakton se komuna është e obliguar që të njoftoj MI për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimeve të projekteve dhe për këtë të kërkoj pëlqim nga MI.

Gjatë testimit të pagesave për tri projekte (bashkëfinancim me komuna) kemi identifikuar se kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime të bëra nga menaxheri i projektit të angazhuar nga komuna, nuk ishin marrë pëlqimet nga ministria. Këto mangësi janë vërejtur tek projektet e poshtëshënuara:

Te pagesa e datës 24.06.2020 për kontratën “Ndërtimi i Qarkores së Gjakovës Lot 1” në vlerë 2,167,952€ kishte rritje të sasive në 34 pozicione të kontratës në vlerë 171,605€. Tejkalimi i sasive të këtyre pozicioneve ishte mbuluar nga tepricat e sasive në pozicione tjera të kontratës. Përveç kësaj, kemi vërejtur që nuk ishte realizuar një pozicioni[11] i cili ishte kontraktuar, por ishte realizuar një pozicion tjetër i cili nuk parashihej në kontratë. Vlera e paguar për këtë pozicion në vitin 2020 ishte 48,048€.

Tek projekti "Asfaltimi i rrugëve lokale në qytetin e Kaçanikut" në vlerë 100,162€, kemi vërejtur që janë ndryshuar sasitë e realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar sasitë e kontraktuara. Nga gjithsej 110 pozicione sa ishin në kontratë, 58 prej tyre ishin ndryshuar.

Te projekti "Zgjerimi i rrugës Regjionale R107 në Deçan (Ura e Demes – Carrabreg)" në vlerë 5,884,040€ gjatë analizimi të pagesave të realizuara në vitin 2020 kemi vërejtur që kishte tejkalim të sasive të kontraktuara në 4 pozicione(pa tejkaluar kontratën bazë). Vlera e sasive të tejkaluara ishte 21,613€.

Planifikimi dhe hartimi jo-adekuat i projekteve, ndryshimet në konfiguracionin e terrenit ku realizohen punimet, si dhe nevoja për t’i bërë projektet më funksionale ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar. Ndërsa, mos aprovimi i këtyre ndryshimeve nga ministria ka ndodhur për shkak se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat e tilla të dala nga memorandumet e mirëkuptimit.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa pëlqimin e ministrisë shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe mund të rezultojë në mos përzgjedhjen e operatorit me ofertën më të lirë.

Rekomandimi B4

Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të lidhura nga komunat për projektet që bashkë financohen me ministrinë, të kërkohet pëlqimi paraprak nga ministria siç është e paraparë me memorandumet e mirëkuptimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Mungesa e objektivave të punës dhe vijueshmërisë në punë për 32 nëpunës të komunitetit serb

Gjetja	Rregullorja 05/2010 (neni 7) e shfuqizuar në gusht 2020 me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve (neni 8), përcaktojnë se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik“. Ndërsa, Ligji nr. 06/L – 114 për zyrtarë publik neni 43.2 thekson që Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur “Mbrojta Civile”. Përmes këtij vendimi, MI ka të angazhuar 32 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integrimit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunat në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, në akt emërimet e tyre, të punësuarit janë sistemuar në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri. Deri në muajin tetor 2020, për këta të punësuar nuk na janë ofruar dëshmi të vijimësisë në punë. Nga muaji tetor, të njëjtit ishin nënshkruar në listat e vijimësisë, ndërsa ministria nuk kishte hartuar objektiva të punës, me ç'rast nuk kishte ndodhur as procesi i vlerësimit për punët e realizuara.Sipas konfirmimeve zyrtare të drejtorive përkatëse këta të punësuar nuk kishin realizuar asnjë aktivitet në ministri përgjatë vitit 2020, ashtu siç ishte paraparë me aktemërimet e tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2020, për 32 zyrtarë ishte 162,555€.
Ndikimi	Mungesa e objektivave të punës për 32 punonjës, ndikon drejtpërdrejt në mos arritjen e qëllimeve të përcaktuara nga ministria lidhur me punësimin e tyre.Kjo njëherit mund të shkaktoj edhe pagesa të parregullta.
Rekomandimi C2	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të mundësoj realizimin e aktiviteteve të parapara me aktemërime për këta të punësuar bazuar në objektiva të qarta të përcaktuara paraprakisht nga ministria. Gjithashtu, duhet të bëhet monitorimi i tyre i vazhdueshëm, ashtu siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Shpenzimet për shërbime kontraktuese tjera

Kemi testuar 7 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 9,329€

Çështja C1 - Angazhimi i zyrtarëve në Njësit për Zbatim të Projekteve (NJZP) pa aprovimin e huadhënësit.

Gjetja

Duke iu referuar Ligjit nr 04/L-256 për Ratifikimin e marrëveshjes për hua për Projektin e Magjistrales Prishtinë-Mitrovicë paragrafi 3.04, Ligjit 05/L-097 për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Rehabilitimin e Rrugëve Rajonale dhe Ligjit nr 06/L-063 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq paragrafët 3.02 përcaktojnë se “Për të koordinuar, menaxhuar, monitoruarar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për Projektin, Huamarrësi përveç nëse nuk pajtohet ndryshe me Bankën ,do të prokuroj që Subjekti Ekzekutues të krijoj dhe operoj me njësinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë kohës se ekzekutimit të Projektit, me burimet e nevojshme dhe personel të kualifikuar sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.
Rrjedhimisht, siç është e rregulluar edhe me neni 7 paragrafi 7 të Rregullores 01/2016 e plotësuar me rregulloren 05/2017 “Në rastet kur kërkohet, bazuar në praktikat e kreditorit, vlerësimi para zgjedhjes së punonjësit në Njësi bëhet nga kreditori. Kur ky vlerësim nuk lejohet në bazë të politikave të kreditorit, rezultatet e vlerësimit do të dërgohen për shqyrtim dhe rekomandim te kreditorit. Kontrata do t'i jepet stafit të Njësisë vetëm pasi të ketë marrë miratimin përfundimtar nga kreditori”.

Për projektet e përmendura, ne kemi identifikuar tri raste të personelit të angazhuar tek këto NjZP pa marrë aprovimin nga huadhënësi. Personeli ishte angazhuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm. Angazhimet ishin: një ekspert i financave (Njësia Prishtinë-Mitrovicë); një zyrtar ekspert për buxhet dhe financa (Njësia për Hyrjet dalje të Ferizaj, Prizren Gjilan Rajonale) dhe një zyrtar ndihmës për çështje kulturore (Njësia Kijevë-Zahaq).

Pas pranimit të raportit të auditimit, Ministri me vendim të datës 04.08.2020, kishte shfuqizuar të gjitha vendimet paraprake për themelimin e 4 njësive duke pushuar veprimtaritë e tyre. Pas këtij vendimi, për zyrtarin e angazhuar në "Njësinë Kijevë-Zahaq" nuk kishte tutje pagesa të realizuara, ndërsa pagesat për të angazhuarin në "Njësinë Zgjerimi i Hyrjeve -Daljeve të qytetit Ferizajt, Prizren dhe Gjilan" ishin realizuar deri në fund të vitit. Kjo për faktin se marrëveshja me zyrtarin kishte afat deri me 31.12.2020.

Tutje, zyrtari i angazhuar në "Njësinë Prishtinë-Mitrovicë" vazhdon të jetë i angazhuar në këtë njësi sepse marrëveshja për shërbime të veçanta e lidhur me datë 04.09.2019 ishte lidhur për periudhë 24 muaj.

Pagesa totale të realizuara për këta të punësuar për vitin 2020 ishin 29,165€.

Ndikimi Angazhimi i personelit në NjZP-të pa zbatimin e termave të referencës sipas marrëveshjes me huadhënësin, ndikon në krijimin e shpenzimeve të pa rregullta.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj llogaridhënie adekuate duke identifikuar rastet e angazhimit të personelit në NjZP pa aprovim paraprak nga huadhënësi. Po ashtu, të siguroj rishikimin e përbërjes së anëtarëve në NjZP, për të qenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara nga huadhënësi dhe të parandalojnë angazhimet e tilla në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali në vitin 2020 ishte 14,021,900€, prej tyre ishin shpenzuar 11,646,749€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të vendit, shërbime kontraktuese, shpenzime të qirasë dhe shërbime tjera operative. Ne kemi testuar 26 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 2,486,584€ si dhe 4 mostra për procedura.

Çështja B5 - Avancet e mbyllura pas afatit të lejuar ligjor

Gjetja

Sipas UA 2004/07 për udhëtime zyrtare neni 8 thekson se kërkesa për kompenzim dhe mëditje së bashku me dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet shërbimit për buxhet dhe financa brenda 15 ditë pune nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar.

Në nenin 20 të RVF ministria ka shpalosur 19,695€ avance të pambyllura të cilat kryesisht i takonin viteve paraprake. Me gjithë përpjekjet e ministrisë për ti mbyllur, ato ende janë të hapura.

Tutje, në një rast për vitin për vitin 2020, kemi vërejtur se avanci i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit në shumë prej 1,623€ është mbyllur pas afatit të lejuar prej 15 ditë pune. Avanci ishte mbyllur prej 37 ditë me vonesë.

Shkak për këto vonesa është pakujdesia e shfrytëzuesve të avanceve për t'i kryer detyrimet e tyre me kohë, por edhe e zyrtarëve të financave për të zbatuar përgjegjësitë e tyre ndaj menaxhimit të këtyre fondeve.

Ndikimi

Mos efikasiteti i kontrolleve me rastin e mbylljes së avanceve, mund të ndikoj në moskthimin e mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë të pa autorizuar.

Rekomandimi B5

Ministri të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar mbylljen e avanceve të hapura. Po ashtu, të merren masa konkrete që në të ardhmen zyrtarët të cilët marrin avance për udhëtime zyrtare t'i mbyllin ato me kohë dhe në përputhje me kërkesat e UA.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A12 - Realizimi i projektit të paplanifikuar dhe anashkalimi i procedurave të prokurimit.

Gjetja	Neni 8 i LPP-së përcakton se jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, që saktëson në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal. Ndërsa në nenin 9 të këtij ligji parashihet që para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave. Me tutje neni 28 paragrafi 10 parasheh se "Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv". Pas pranimit të kërkesës nga Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, Udhëheqësi i Divizionit të Mirëmbajtjes Verore dhe Dimërore në kuadër të ministrisë, përmes Drejtorit të Drejtorisë për Menaxhim të Rrugëve, me datë 18.07.2019 i kishte drejtuar kërkesë menaxherit të kontratës "Mirëmbajta verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës, Regjioni Mitrovica2" që të kryen punimet në asfaltimin e rrugës Anke-Spajiq që lidhë vendbanimet multietnike në Mitrovicën e Veriut duke përdorur kontratën e mirëmbajtjes. Mjetet e shpenzuara për këtë projekt ishin 139,573€. Ne kemi vërejtur që projekti në fjalë nuk ishte pjesë e tabelave buxhetore të aprovuara në vitin 2019 dhe për të njëjtin nuk ishte hartuar paraprakisht një projekt ekzekutiv.
Ndikimi	Realizimi i projekteve të tilla të paplanifikuara paraprakisht, me mjetet e kontratave të planifikuara për mirëmbajtje të rrugëve mund të shkaktoj shkëputje të parakohshme të këtyre kontratave duke pamundësuar realizimin e shërbimeve për periudhën e paraparë ose tejkalimin e tyre. Gjithashtu anashkalimi i procedurave të prokurimit në raste të tilla ndikon në diskriminim dhe dëmtim të konkurrencës për OE që do të mund të kishin interes të aplikojnë në rast se ky proces do të ishte transparent. Mungesa e projektit ekzekutiv, mund të shkaktoj realizimin e punimeve jo në harmoni me standardet e kërkuara.
Rekomandimi A12	Ministri duhet të sigurohet që kërkesat e tilla të palëve tjera të shqyrtohen në dakordim me rregullativën ligjore dhe realizimi i projekteve të bëhet vetëm pasi të aplikohen të gjitha procedurat e parapara me ligj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A13 - Pagesat për shërbime të telefonisë mobile,fikse dhe shpenzime postare pa kontratë/marrëveshje në mes palëve.

Gjetja	Neni 21 i Rregullës Financiare 01/2013 Për Shpenzimin e Parasë Publike, specifikon se "Për shkak të natyrës së tyre, disa blerje nuk kërkojnë proces prokurimi. Në raste të tilla,moduli i blerjes nuk ka nevojë të përdoret për t'i zotuar fondet por duhet zotuar fondet duke përdor modulin e aprovimeve.Shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: pagat, shpenzimet e paguara me para e imët, avancat për udhëtime, komunalit, subvencionet dhe transferet, transaksionet ndërdepartamentale. Ministria në vitin 2020 kishte pranuar dhe paguar shërbimet e telefonisë mobile, fikse dhe shpenzime postare në mungesë të një kontrate. Ministria nuk kishte lidhur ndonjë herë marrëveshje për këto shërbime me arsyetimin se këto shërbime janë pranuar nga një ndërmarrje publike (bazuar në konfirmimet zyrtare të ministrisë). Vlera totale e këtyre pagesave për vitin 2020 ishte 43,029€. Kjo kishte ndodhur për shkak të kuptuarit jo të drejtë të kërkesave ligjore nga zyrtarët përgjegjës.
Ndikimi	Pranimet e shërbimeve pa mbështetje në dokumente ligjore, siç është kontrata, mund të shkaktojnë pranim të shërbimeve të pafavorshme dhe jo në përputhje me çmimet e tregut.
Rekomandimi A13	Ministri duhet të gjej një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 141,361,544€. Prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 77,417,742€ apo 58%. Ato kanë të bëjnë me ndërtime të rrugëve, shtresime të rrugëve, bashkëfinancime të projekteve bazuar në Memorandumet me komunat, mirëmbajtje e rrugëve, etj. Faktorët që kanë ndikuar në nivelin e ulët të shpenzimeve janë ngecjet në ekzekutimin e projekteve të planifikuara nga klauzola e investimeve (35,510,113€) të cilat nuk ishin realizuar fare, si dhe vonesa në ekzekutimin e projekteve të financuara nga huamarrjet (13,018,113€ të pa realizuara). Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 36,628,922€, si dhe 2 mostra për procedura. Po ashtu kemi testuar edhe 38 mostra nga kodi ekonomik “Ndërtimi i Rrugëve Regjionale në” në vlerë 3,302,058€ për testim të klasifikimit të shpenzimeve. Gjatë vitit 2020 ka pasur realizim të ulët të punimeve dhe pagesave për arsye se, për disa projekte nuk është rregulluar çështja e shpronësimit. Rrjedhimisht, si rezultat i vonesave në kryerjen e obligimeve ndaj pronarëve të pronave janë paraqitur pengesa nga pronarët në kryerjen e punëve. Shkak i mos realizimit të buxhetit ishte edhe pandemia COVID-19 sepse me vendime të qeverisë për pjesën e parë të vitit ishin pezulluar aktivitetet e inicimit të projekteve të reja dhe gjithashtu edhe aktivitetet e realizimit të punimeve për projektet ekzistuese.

Çështja A14 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja	Marrëveshjet kontraktuale të lidhura në mes të Ministrisë dhe operatorëve ekonomik për projektet e poshtëshënuara specifikojnë periudhën përmes planit dinamik për përfundimin e punimeve.

- Sipas planeve dinamike të 8 kontratave të nënshkruara në vlerë totale 81,371,426€ për '' Ndërtimin e Autoudhës : Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, Segmenti: Banullë – Bresalc l=22.31 km'', ky projekt ishte paraparë të përfundohet në gusht 2020, mirëpo i njëjti, nuk ishte përfunduar ende. Sipas menaxhereve të projekteve ndër shkaqet kryesore për këto vonesa ishin gabimet në projektin realizues nga projektuesi i kontraktuar, problemet me shpronësimet (shkak i mungesës së mjeteve për shpronësim, por edhe mosmarrëveshjet me komunitetet), pasuritë arkeologjike, mungesa e mjeteve të buxhetuara nga ministria e po ashtu edhe ndalimi i punimeve në nivel kombëtar si pasojë e pandemisë Covid 19.Për periudhën 2018-2020 pagesa të realizuara për këto kontrata ishin në vlerë 51,123,368€.
- "Projekti Rikonstruktim i Rrugës Miradi-Zona Industriale" (vlera 810,806€) kontrata ishte nënshkruar me datë 14.11.2019 dhe afati i realizimit të punëve ishte 95 ditë pune. Deri në fund të vitit 2020 vlera e realizuar e projektit ishte 68,399€ apo vetëm 8 % e vlerës së kontraktuar. Vonesat në realizim ishin për shkak të kontesteve gjyqësore me INFRAKOS. Përmes shkresës zyrtare të dorëzuar nga kjo e fundit në Drejtorinë e Rrugëve me datë 15.06.2020 kërkohet ndërprerja e punimeve për shkak se pjesa në të cilën ishte duke u zgjeruar rruga përveç që është në pronësi të Infrakosit, pamundëson realizimin e projektit "Rehabilitimi Gjeneral dhe Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore (Leshak – Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit) të cilin ishte duke e ekzekutuar Infrakosi. Sipas kësaj shkrese, edhe pse gjykata kishte lëshuar vendim për ndërprerjen e punimeve me datë 10.06.2020, ministria nuk e kishte përfillur vendimin e gjykatës. Punimet kishin vazhduar deri me datë 07.07.2020.
- Me datë 05.04.2018 ishte nënshkruar kontrata për projektin "Zgjerimi i Rrugëve Nacionale N25 Segmenti rreth-rrotullimi Besi-Podujevë Lot 4" (vlera 4,557,224€). Afati i paraparë për përfundimin e punëve ishte 60 ditë pune. Deri në fund të vitit 2020 vlera e punëve të realizuara ishte 2,088,891€ ose 46% e vlerës së kontraktuar.
  Mos realizimi i shpronësimit të pronave private ishte shkak kryesor i vonesave të shumta në realizimin e këtij projekti.
- Për projektin "Ndërtimi dhe Asfaltimi i Rrugës – Memoriali Dem Ahmeti-Rumeqiq-Padezh-Permalin, Podujeve", kontrata ishte nënshkruar me datë 11.06.2020 në vlerë 349,618€ dhe afati i përfundimit të punëve ishte përcaktuar deri më 21.09.2020. Deri në fund të vitit 2020 nuk ishte realizuar asnjë pagesë. Kjo për faktin se rruga kalon në prona private të cilat nuk ishin shpronësuar.

Ndikimi

Mos ekzekutimi i kontratave sipas afateve kohore, ndikon që ministra potencialisht të hyjë në obligime financiare ndaj kompanive kontraktuese për shkak të kostove shtesë që kanë ato dhe kërkesave për shpërblimin e fitimit të humbur siç parashihet edhe tek kushtet e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me këta OE. Përveç kësaj, vonesat e lartcekura shkaktojnë mos realizimin e objektivave dhe pengesa në qarkullimin e qytetarëve.

Rekomandimi A14 Ministri duhet të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe implementimin e projekteve për investime kapitale e në fokus të veçantë të jenë autoudhat si projekte madhore dhe komplekse në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore. Para inicimit të projekteve, ministria duhet paraprakisht të pajiset me leje ndërtimore për projektet e caktuara ku kësaj procedure i paraprinë edhe realizimi i shpronësimeve të cilat parashihen për realizimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A15 - Mungesa e raportimeve nga njësitë për punët e realizuara

Gjetja Marrëveshjet kontraktuale të lidhura midis Ministrisë së Financave dhe institucioneve ndërkombëtare huamarrëse specifikojnë periudhën e kthimit të kredisë dhe afateve për kryerjen e punës.

Projekti ‘’Autoudha Kijevë – Zahaq ‘’e financuar nga BERZH në bashkëfinancim me Bankën Evropiane të Investimeve (Marrëveshja sipas Ligjit 06/L-063) e nënshkruar në vitin 2018 në vlerën prej 71,000,000€, kishte vonesë 36 muaj në realizimin e procedurave fillestare të projektit.

Gjithashtu marrëveshja e lartpërmendur, në nenin III Realizimi i projektit thekson se MI duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përfundimin e projektit përmes Njësisë Zbatuese të Projektit(NJZP-së) në bazë të afateve të përcaktuara e cila do të bëjë edhe menaxhimin e konsoliduar financiar dhe të prokurimit.

NjZP e themeluar për implementimin e këtij projekti kishte 13 zyrtarë të cilët për periudhën 2018 deri Shkurt 2020, ishin paguar 187,440€. Megjithatë, nga kjo njësi nuk kishte ndonjë raportim mbi mbarëvajtjen e punëve lidhur me projektin nën mbikëqyrje. Vlen të theksohet se pas periudhës shkurt 2020 ishin kryer disa aktivitete nga njësia (organizimi i dëgjimeve publike, përgatitja e dosjes së tenderit dhe projekti detal, Elaborati i Shpronësimit dhe marrja e vendimit të qeverisë për shpronësimin e pronave në këtë segment).

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes së kësaj njësie nga menaxhmenti i ministrisë.

Ndikimi Mungesa e raportimit nga zyrtarët përgjegjës lidhur me mbarëvajtjen e projektit ndikon në llogaridhënie të dobët dhe mosrealizim të qëllimit për të cilin është iniciuar projekti në fjalë.

Rekomandimi A15 Ministri të sigurojë se projektet e iniciuara realizohen sipas marrëveshjeve kontraktuale përkatëse dhe në rastet e vonesave të paarsyeshme të merren masat që parashihen me këto marrëveshje. Po ashtu, Ministri të sigurojë se NjZP është duke kryer funksionin e saj në përputhje me qëllimin për të cilin është themeluar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A16 - Ndërprerje e punimeve në projektin ‘’Zgjerimi i pistës, ngritja e sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemit të radio komunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari ‘’

Gjetja

Ministria me datë 09.08.2017 kishte nënshkruar kontratë publike për projektin “Zgjatja e pistës, ngritja e sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemit të radio komunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari”, në vlerë 33,566,305€. Sipas kushteve të veçanta të kësaj kontrate data e përfundimit të punëve do të jetë 18 muaj.

Me realizimin e këtij projekti në linjë me nevojat strategjike të zhvillimit të sektorit të Aviacionit Civil, ministria kishte për qëllim zgjatjen dhe ngritjen e kapacitetit të pistës së Aeroportit[12]. Mirëpo, objektivat e synuara nuk ishin realizuar për periudhën e paraparë, për shkak të skadimit të kontratës me kompaninë e angazhuar për mbikëqyrjen e realizimit të këtij projekti. Rrjedhimisht, në muajin gusht 2020 ishte bërë ndërprerja e punimeve për këtë projekt.

Vlen të ceket se kontrata me kompaninë mbikëqyrëse ishte lidhur me afat kohor për 18 muaj dhe jo deri sa të përfundohet projekti. Për më tepër, as në periudhën e parë të vitit 2021 ministria nuk kishte iniciuar procedurat e tenderimit për angazhim të ndonjë kompanie profesionale për mbikëqyrjen e këtij projekti. Pagesat e realizuara deri në fund të vitit 2020 ishin 22,599,799€ ose 67% e totalit të kontratës.

Për më tepër, sipas ligjit të buxhetit nr. 07/L-041 mjetet e vlerësuara për periudhën 2021-2024 për këtë projekt janë 2,248,000€ kurse punët e pa realizuara sipas kontratës me kompaninë punëkërkuese janë 10,966,506€. Punët e mbetura sipas planit të azhurnuar pritet të kryhen deri në fund të vitit 2021.

Mos realizimi i procedurave të tenderimit për angazhimin e kompanisë mbikëqyrëse kishte ndodhur për shkak të mos dakordimit në mes të Departamentit të Aviacionit Civil, Departamentit të Prokurimit dhe Koordinatorit të Projektit për procedurat e duhura të prokurimit. Mungesa e kërkesave me kohë për buxhet nga drejtorët e departamenteve kishte ndikuar në planifikimin e pamjaftueshëm të buxhetit për këtë projekt.

Ndikimi

Mos koordinimi në mes departamenteve përkatëse ka rezultuar me ndërprerje të punimeve për më shumë se 10 muaj duke shkaktuar vonesa të shumta në arritjen e qëllimeve strategjike të synuara me këtë projekt.

Rekomandimi A16

Ministri duhet të sigurojë që procedurat e përzgjedhjes së kompanisë mbikëqyrëse të realizohen në afat sa më të shkurtër kohor në mënyrë që të evitohen vonesat në realizimin e projekteve. Po ashtu, Ministri duhet të siguroj që planifikimi i buxhetit të bëhet në harmoni me kontratat e nënshkruara dhe planet dinamike të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A17 - Realizimi i kontratave në mungesë të sigurimeve të vazhduara të ekzekutimit

Gjetja

Neni 30.06 i RRUOPP -së thekson "Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas kompletimit të kontratës".

Në 8 raste shuma e sigurisë së ekzekutimit është kërkuar 10% nga vlera e përgjithshme e kontratës dhe duhej të kishte afat mbulueshmërie deri në 30 ditë pas përfundimit të punimeve të përcaktuara në planin dinamik. Mirëpo:

- Te kontrata “Zgjerimi i pistës, ngritja e sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemit të radio komunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari”, vlera e kontratës 33,566,305€ polisa e sigurimit prej 10% e kërkuar nga MI është dorëzuar vetëm deri me 01.03.2019. Nga kjo periudhë e tutje nuk është vazhduar polisa e sigurimit edhe pse projekti akoma nuk është përfunduar;
- Për projektin "Autostrada Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë-Segmenti: Banullë-Bresalc l=22.31 km", për 7 kontrata të lidhura nuk na janë ofruar dëshmitë nëse policat e sigurisë së ekzekutimit janë vazhduar pas skadimit të tyre, nën arsyetimin se dosja administrative e projektit në fjalë është në polici.

Mangësitë e lartpërmendura kanë ndodhur për shkak të lëvizjeve të shpeshta të personelit në zyrën e prokurimit, pandemisë Covid 19 dhe pakujdesisë së zyrtareve përgjegjës për sigurimin e këtyre dokumenteve.

Ndikimi

Realizimi i kontratave në mungesë të sigurisë së ekzekutimit rrit rrezikun që në rast të shkëputjes së njëanshme të kontratave apo mos realizimit të projekteve konform kushteve të përcaktuara me kontratë, autoriteti kontraktues të mos mund ti realizoj kompensimet nga operatorët ekonomik.

Rekomandimi A17

Ministri duhet të siguroj që zyra e prokurimit është duke mbikëqyrur zhvillimin e proceseve të prokurimit dhe realizimi i kontratave kryhet brenda kornizës ligjore. Në mënyrë specifike në rastet kur paraqiten vonesa në realizimin e projekteve, të sigurohet se janë vazhduar siguritë e ekzekutimit për ato projekte.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A18 - Mangësi në hartimin e projekteve nga kompania e kontraktuar nga MI

Gjetja

Në kontratën e lidhur nga ministria për "Hartimin e Projektit Kryesor për Zgjerimin e Rrugës Nacionale N25.3, Segmenti Prishtinë Gjilan Konqul 51Km" te pika 3 e detyrave projektuese parashiheshin edhe kërkesat e përgjithshme dhe parametrat teknik për projektimin e rrugës. Sipas këtyre kërkesave, projektuesi duhej të hartojë projektin ideor dhe kryesor me elaboratet dhe projektet përcjellëse, ku projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet e largpërçuesve, rrjetin e telefonisë, të ujësjellësit dhe instalimet tjera. Duhet të bëhen zgjidhjet për largimin e ujërave, dimensionet e konstruksionit të tokës sipas kategorive të tokës dhe duhet të parashihen nënkalimet dhe mbikalimet për automjete dhe këmbësorë. Kështu që, sipas kërkesave të parashtruara, duhet përfshirë matjet gjeodezike, punimi i shqyrtimeve gjeomekanike të nevojshme për punimin e projektit kryesor, shpimet, analizat laboratorike dhe punimi i elaboratit gjeoteknik.

- Si rezultat i hartimit të projektit jo në përputhje me specifikimet teknike nga kompania projektuese, gjatë implementimit të kontratës ''Ndërtimi i Autoudhës : Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë – Segmenti: Banullë – Bresalc l=22.31 km'' tek Lot 1 dhe Lot 3 ishte paraqitur nevoja për ndryshime. Ndryshimet që kanë qenë të nevojshme të aplikohen ishin në pozicionet gërmimi dhe mbushja, lëshesat pllakore, largimi dhe kullimi i ujërave atmosferikë dhe ndryshimi i gjatësisë së gardhit.

Vlen të ceket se në shumicën e rasteve të testuara ishin shfaqur probleme të tilla duke mos korresponduar gjendja faktike me projektet ekzekutive të rrugëve, që po ashtu ishin ndër shkaqet kryesore të mangësive të identifikuara përmes auditimit tonë dhe të prezantuara në këtë raport.

Kjo ka ndodhur pasi që kompania projektuese gjatë hartimit të projekteve nuk kishte përfillur kërkesat e përgjithshme të parametrave teknik sipas kontratës.

Ndikimi

Hartimi i projekteve jo në pajtueshmëri me kërkesat teknike, rezulton me mos ndërtimin e rrugëve në afatet e parapara me kontratë, pamundëson planifikimin e vlerës reale të investimeve, rrit nevojën e kërkesave për punë shtesë që në fazën e inicimit të punimeve duke shkaktuar kosto dhe procedura shtesë për përfundimin e projekteve.

Rekomandimi A18

Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në terren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A19 - Kohëzgjatja e kontratës jo në pajtueshmëri me njoftimin për dhënien të kontratës

Gjetja

Në njoftimin për kontratë pika 2.3, kohëzgjatja e kontratës apo afati kohor për përfundimin e punimeve ishte 65 ditë nga dhënia e kontratës.

Kontrata “Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Memoriali Dem Ahmeti-Rumeqiq-Padesh-Permalin,Podujevë” e nënshkruar me datën 12.06.2020, në vlerë 246,016€ ishte nënshkruar për periudhë 95 ditë pune e jo 65 ditë siç ishte paraparë në njoftim për dhënie të kontratës.

Ndikimi Ndryshimi i afatit të kontratave me procedura të brendshme të zbatuara nga ministria, kundrejt njoftimit publik për kontratë, rrezikon transparencën e procesit.

Rekomandimi A19 Ministri të siguroj se nënshkrimi i kontratave nga zyra e prokurimit të bëhet në pajtueshmëri të plotë me afatet kohore të publikuara në njoftimin për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Dobësitë në certifikimin e lëndëve

Gjetja Neni 25 paragrafi 1 i Rregullores 01/2013 Për Shpenzimin e Parasë Publike specifikon se "Para së të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, dokumentacioni për pagesë dorëzohet te zyrtari çertifikues, i cili është përgjegjës që dokumentacioni të jetë i kompletuar: 1.1 Të posedoj zotimin/kërkesën për blerje, shpalljen e tenderit, kontratën, urdhërblerjen, raportin e pranimit dhe fatura e pranuar. 1.2 Të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave; 1.3 Kërkesa për pagesë ka kodin e duhur të nën-artikullit të shpenzimit në klasifikimin e shpenzimeve; 1.4 Janë zbatuar të gjitha nivelet e kontrollit të brendshëm financiar” Ndërsa paragrafi 2 specifikon se “Nëse kushtet e dhëna më sipër nuk janë plotësuar, atëherë zyrtari certifikues nuk do ta certifikojë dokumentacionin për pagesë”.

Në shumicën e rasteve të testuara, kemi identifikuar se zyrtari çertifikues në momentin e certifikimit nuk kishte në dosje të pagesës specifikacionin teknik, respektivisht çmimet e kontraktuara si dhe situacionet e ndara që pasqyrojnë punët e kryera për faturat përkatëse. Në dosjen e pagesës ishin vetëm dy fletët e para të kontratës. Pagesat e certifikuara si dëshmi kishin situacionet e pranuara nga menaxherët të cilat pasqyrojnë punën totale (në mënyrë kumulative) nga lidhja e kontratës apo nga fillimi i punëve deri në datën e pagesës, e jo situacionin/punën e cila ndërlidhet me pagesën aktuale. Duke pas parasysh këtë, një përcjellje e punëve të kryera bazuar në faturë duke e ndërlidhur me certifikatën e aprovuar për pagesë dhe kontratën ka qenë e pamundur. Ne këto mostra i kemi testuar në bashkëpunim me menaxherët e kontratave përkatëse, duke kërkuar librat ndërtimor, në bazë të të cilave kemi shikuar sasinë e punëve të realizuara për pagesë.
Vlen të ceket se pas rekomandimit të dhënë në raportin e vitit 2019, menaxheret e kontratave në disa raste kishin filluar të dorëzonin situacionet për punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë, por pa përfshire edhe sasitë dhe vlerën komulative të realizuar për kontratat përkatëse.

Shkak për këtë ishte mos kuptimi i drejtë i kërkesave ligjore nga zyrtarët financiar, e po ashtu, zyrtarët e ministrisë (menaxherët e projekteve) e kishin konsideruar si një praktikë të mirë, formën e certifikatave të përdorura.

Ndikimi Certifikimi i pagesave në mungesë të specifikacioneve teknike që janë pjesë e kontratës dhe situacioneve të ndara për çdo faturë ndikon në rritjen e rrezikut që të certifikohen pagesa jo në harmoni me sasitë dhe çmimet e kontraktuara, duke i shkaktuar edhe humbje financiare Ministrisë. Po ashtu, neglizhenca e zyrtarëve gjatë procesimit të lëndës për pagesë rritë rrezikun e autorizimit të pagesave të parregullta dhe jo në përputhje me marrëveshjet kontraktuale.

Rekomandimi B6 Ministri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe certifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Pranimi teknik i punëve dhe projekteve nga komisionet me përbërje jo kompetente

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2008/3 neni 2 pika 3 e thekson se 'Anëtarët e komisionit të ekspertëve për mbikëqyrje të punëve, pranim teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera duhet të jenë persona me kualifikim dhe njohuri të specializuara në sektorin e infrastrukturës rrugore nga lëmi i ndërtimtarisë, sigurisë në komunikacionin rrugor, e të ngjashëm'.

Për projektet ''Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Sikivjan- Novosellë''dhe "Ndërtimi i rrugës Demjan-Pnish" kemi identifikuar se përbërja e komisioneve për pranimin e punëve nuk ishte nga anëtarët me kompetencë dhe njohuritë nga fusha e kërkuar. Pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit, ishte bërë nga komisionet në përbërje të një inxhinieri dhe dy ekonomistëve.

Kjo çështje ishte ngritur edhe në raportet paraprake të auditimit, mirëpo ministria nuk e kishte adresuar në arsyetimin e numrit të madh të projekteve dhe numrit të pamjaftueshëm të inxhinierëve.

Ndikimi Pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit nga zyrtarë jo kompetent, rritë rrezikun e pranimit të projekteve jo në pajtueshmëri me standardet dhe cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi B7 Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar nëpajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,592,171,944€ pasurive jokapitale është 112,702, si dhe e stoqeve 105,349€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 612,066,494€.

Çështja B8 - Mos finalizimi i procesit të inventarizimit të pasurive

Gjetja	Nenin 18 paragrafi 3 i Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në OB përcakton se ”Organizatat buxhetore të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare. Ndërsa neni 19 paragrafi 4.3, komisioni për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare ka përgjegjësi të bëjë krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat pasurive jo financiare, dhe paragrafi 4.7 parasheh hartimin e raportit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare”. Edhe pse me datë 11.11.2020 Sekretari kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare, mirëpo ky komision nuk kishte dorëzuar raport përfundimtar të gjendjes së inventarizuar të pasurive edhe pse sipas vendimit afati i fundit për dorëzimin e këtij raporti ishte 15.01.2021. Rrjedhimisht, pasuritë e regjistruara në RVF të vitit 2020 nuk ishin harmonizuar me rezultatet e procesit të inventarizimit Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni i inventarizimit nuk i ka kryer detyrat në pajtim me vendimin për caktimin e komisionit.
Ndikimi	Mos realizimi i procesit të inventarizimit nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.
Rekomandimi B8	Ministri duhet të siguroj se është finalizuar procesi i inventarizimit dhe është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në mënyrë që të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Ministria në PFV-të e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,269,824€. Kjo vlerë përbëhet nga obligimet e pa arkëtuara për më shumë se 30 ditë nga faturimet për pompa të karburanteve, transport të jashtëzakonshëm, qiraja, hyrje-daljet e objekteve afariste, vendosje e infrastrukturës nëntokësore dhe të tjera.

Çështja B9 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme dhe mos ndërmarja e veprimeve për inkasim

Gjetja

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ 1/2014 mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale përcakton se"Tarifat për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, shfrytëzimin e tokës e cila jepet me qira dhe vendosje të objekteve të përkohshme, behet sipas tarifave të përcaktuara". Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara në mes MI dhe shfrytëzuesve të pronës publike përcaktohen afatet e inkasimit të arkëtueshmeve.

Nga gjashtë (6) mostrat e testuara në vlerë prej 143,286€ kemi identifikuar se MI nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të zvogëluar llogaritë e arkëtueshme. MI vetëm ka dërguar faturat te qiramarrësit, mirëpo nuk ka ndërmarrë veprime për arkëtimin e të hyrave. Tre (3) nga gjashtë rastet e testuara, qiramarrësit nuk kishin paguar qiranë për shfrytëzimin e pronës publike nga viti 2008, një rast nga viti 2012 kurse dy (2) rastet tjera, pagesën do të duhej ta kryenin që nga viti 2016.

Gjithashtu, ministria nuk ka ndonjë procedurë apo udhëzim se si do të menaxhoj dhe trajtoj Llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk inkasohen për një periudhë të gjatë kohore.

Gjatë fazës së auditimit ne kemi pranuar tre regjistra të ndryshëm të llogarive të arkëtueshme nga zyrtarët e ministrisë. Vlerat e prezantuara ishin të ndryshme duke shkaktuar paqartësi lidhur me saktësinë e prezantimit të llogarive të arkëtueshme në RVF.

Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave. Gjatë fazës se auditimit ne kemi pranuar tre regjistra të ndryshëm të llogarive të arketueshme nga zyrtaret e ministrisë. Vlerat e prezantuara ishin të ndryshme duke shkaktuar paqartësi lidhur me saktësinë e prezantimit të tyre.

Ndikimi

Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave.

Rekomandimi B9

Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave në inkasimin e këtyre pagesave dhe dhe të krijojë mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve nga debitorët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit e prezantuar në RVF 2020, ishte 33,680.80€.

Çështja B10 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja	Neni 37 paragrafi i i Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike përcakton "Të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë". Në 12 pagesa të kategorisë investime kapitale dhe në 4 pagesa të kategorisë mallra dhe shërbime, faturat apo obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 1,587,461€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 1 deri në 7 muaj. Shkak për vonesat në pagesa ishin kryesisht mungesa e mjeteve financiare, pasi që për disa nga këto projekte në vitet e mëparshme ishin lidhur kontrata pa fonde të mjaftueshme.
Ndikimi	Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që ministria duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak dhe gjithashtu rrit rrezikun që në periudhat e ardhshme ministria të ballafaqohet me konteste gjyqësore apo veprime përmbarimore të cilat njëherit mund të rezultojnë me obligime shtesë për ministrinë.
Rekomandimi B10	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rishikoj mekanizmat e kontrollit në sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.7 Funksioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). NjAB operon me dy anëtarë dhe Drejtorin e Auditimit. Pozicionimi i NjAB në strukturën organizative i shërben misionit të saj të përcaktuar me statut. Plani i Auditimit të Brendshëm fillimisht parashihte 10 auditime të rregullta të përcaktuara sipas prioritetit të lartë (7), të mesëm (2) dhe (1) sipas kërkesave ad hoc. Mirëpo për shkak të rrethanave të paraqitura me pandeminë COVID-19 ky plan ishte reduktuar në vitin 2020 duke paraparë vetëm 4 auditime prej të cilave kanë arritur të realizohen 2 auditime të rregullta (Auditimi i Financave dhe Drejtorisë së Menaxhimit të Rrugëve) dhe 6 auditime ad hoc. Ne kemi ekzaminuar planin e zbatimit të rekomandimeve dhe sipas raporteve të AB gjatë vitit janë dhënë 36 rekomandime dhe prej tyre, ishin zbatuar 42%. NjAB ka hartuar raporte të rregullta periodike për aktivitetet e saj. Edhe pse komiteti i Auditimit ishte i themeluar, i njëjti nuk kishte qenë funksional gjatë vitit 2020.

Çështja A20 - Komiteti i auditimit jo funksional

Gjetja

Në dispozitat e UA MF-NR. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Neni 5.1 definon se 'Komiteti i Auditimit ndihmon udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës'. Po ashtu, paragrafi 2 i këtij neni thekson se 'Komiteti i Auditimit mbështet Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik'.

Ministria e Infrastrukturës në vitin 2018 e kishte themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB), por gjatë vitit 2020 ky komitet nuk kishte qenë funksional dhe për pasojë nuk kishte mbajtur asnjë takim siç kërkohet me udhëzimin administrativ.

Vlen të theksohet se NjAB kishte njoftuar menaxhmentin lidhur me mungesën e funksionimit të KA por gjatë vitit 2020 menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret lidhur me funksionalizimin e tij.

Mos funksionalizimi i Komitetit të Auditimit gjatë vitit 2020 është ndikuar nga ndryshimet në udhëheqjen e ministrisë.

Ndikimi

Një situatë e tillë zbeh ndikimin e proceseve të kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe pamundëson mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe marrëdhënies së tij me menaxhmentin në drejtim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi A20

Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1	**Korrigjimi i pasqyrave financiare vjetore**
Gjetja	Tek Neni 13 pasqyra e pranime dhe pagesave në para të gatshme- burimi i fondeve/pranimet- Në kolonën e parë nuk është prezantuar vlera e pranimeve/shpenzimeve nga fondi 06 (klauzola e investimeve). Sipas analizës tonë vlera e klauzolës së investimeve është prezantuar si total tek fondi 04 Financimet nga huamarrja dhe jo ndaras nga njëra tjetra. Tek Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit tek kolona e buxhetit fillestar dalja e parasë së gatshme në shënimin 6 (investimet kapitale) ishte prezantuar 211,617,000€ ndërsa sipas Ligjit të Buxhetit fillestar (NR. 07/L-001) vlera e planifikuar për investime kapitale ishte 217,778,671€. Pra, diferenca në mes vlerës së prezantuar në PVF me ligjin e buxhetit është 6,161,608€. Gjithashtu, tek kjo pjesë në kolonën realizimi i vitit 2018 ishte prezantuar vlera 304,573,000€, ndërsa sipas shënimeve të prezantuara në PVF e vitit 2018 realizimi ishte 244,826,294€. Diferenca 59,746,706€. Përveç kësaj, buxheti fillestar dhe final tek pjesa hyrja e parasë së gatshme të hyrat vetjake, nuk ishin prezantuar sipas informimit të dërguar nga MF për projeksionet e të hyrave datë 27.01.2021. Tek Neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit tek pjesa hyrja dhe dalja- Buxheti fillestar për të hyra dhe investime kapitale ishte prezantuar me gabimin ashtu siç u përmend më lart. Përveç kësaj nuk ishin dhënë detaje të mjaftueshme për ndryshimet e ndodhura në buxhetin e ministrisë gjatë vitit. Më tutje, nuk janë dhënë shpjegimet e nevojshme lidhur me ristrukturimet që ka pasur gjatë vitit kjo ministri dhe të cilat kanë ndikuar në lëvizjet buxhetore. Tek Shënimi 3 – Mallra dhe Shërbime- Buxhetit final ishte prezantuar gabimisht 11,497,000€, përderisa duhet të jetë 13,856,825€. Diferenca 2,359,825€. Tek Shënimi 6- Investime Kapitale- shpenzimi nga grandi i qeverisë i prezantuar 52,336,000€ ishte gabim përderisa do të duhej të ishte 49,226,828€. Përveç tjerash vlerat e prezantuara në kolonat tjera janë çorientuese dhe jo të sakta.
Veprimi i kërkuar	MI duhet të ndërmarrë masa konkrete që të eliminoj mangësitë e evidentuara në mënyrë që PFV të pasqyrojnë gjendjen e drejtë dhe të vërtetë.

Rezultati Pas pranimit të shkresës tonë, MI kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme duke korrigjuar dhe shpalosur të gjitha informacionet në RVF.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[14]	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**243,697,609.00**	**158,525,421.98**	**92,170,794.24**	**196,989,432.38**	**244,826,293.11**
Grante Qeveritare - Buxheti	137,205,609.00	75,689,647.95	63,943,146.99	124,357,255.78	166,079,589.00
Financimi përmes huamarrjes	18,700,000.00	18,300,000.00	6,424,933.21	9,985,699.82	4,293,371.50
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	40,792,000.00	37,130,000.00	5,281,876.61	0.00	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	47,000,000.00	27,405,774.03	16,520,837.43	62,646,476.78	74,453,332.61

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 85,172,187€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2020 në kodin organizativ të kësaj ministrie ishte e përfshirë edhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Më pas, për shkak të ndryshimeve politike është bërë ristrukturimi i qeverisë dhe MI është kthyer prapë në strukturën e saj ngjashëm si në vitin paraprak. Edhe përkundër shkurtimeve, buxheti në fund të vitit kishte rezultuar me një tepricë buxhetore prej 66,354,628€.

Në vitin 2020, ministria ka shpenzuar 58% të buxhetit final ose 92,170,794€, që është për 7% më ulët se në vitin 2019. Vlen të ceket se në vitin 2019 buxheti final ishte 52 % me i lartë krahasuar me vitin 2020. Realizimi i ulët i shpenzimeve kryesisht ndikohet nga projektet e planifikuara nga burimet e financimit të huamarrjes (të planifikuara 18,100,000€, ndërsa të realizuara vetëm 6,688,533) dhe klauzolës së investimeve (të planifikuara 40,792,000€ dhe të realizuara 5,576,823€). Mjetet nga huamarrja ishin të destinuara për projektin "Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë" ndërsa mjetet nga klauzola e investimeve ishin destinuar për projektet "Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale" dhe "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit". Pra, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**243,697,609.00**	**158,525,421.98**	**92,170,794.24**	**196,989,432.38**	**244,826,293.11**
Pagat dhe mëditjet	4,087,032.00	1,805,501.98	1,805,501.98	1,812,207.59	1,829,910.67
Mallrat dhe shërbimet	19,729,682.00	13,856,825.24	11,488,445.37	8,371,108.55	6,594,680.37
Komunalitë	358,410.00	165,075.21	158,303.97	145,970.23	154,243.06
Subvencionet dhe transferet	1,743,814.00	1,336,474.80	1,300,799.99	1,502,676.20	1,041,742.91
Investimet Kapitale	217,778,671.00	141,361,544.75	77,417,742.93	185,157,469.81	235,205,716.10

Buxhetit final ishte zvogëluar krahas buxhetit fillestar për të gjitha kategoritë me rishikim të buxhetit për shkak të ristrukturimit të kësaj ministrie dhe vendimeve të ndryshme nga qeveria për ndarje, kursime dhe rregullime buxhetore si pasoj e situatës së krijuar me pandeminë COVID 19.

Dëshmi të ofruara nga ministria lidhur me pagesat e realizuara për shpenzime të Covid-19 të në vitin 2020 ishin në vlerë 1,725€ të realizuara nga kategoria e mallrave shërbimeve si furnizime për zyre.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020




Bazuar në diagramin e mësipërm, në vitin 2020 shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishin pothuajse ngjashëm me vitet 2018 dhe 2019 me rënie të vogël krahasuar me vitet e mëparshme.

Për kategorinë mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale realizimi i shpenzimeve në vitin 2020 kishte rritje 42% krahasuar me vitin 2018 dhe 27% krahasuar me vitin 2019. Kjo për shkak se me ligj të buxhetit 07/L-001 në nenin 24, shumat e buxhetuara në kategorinë e investimeve kapitale të katër projekte të mirëmbajtjes së rrugëve ishin bartur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere ishin realizuar 20% më lartë se në vitin 2018 dhe 13% më ulët se vitin 2019.

Ndërsa, për investime kapitale shpenzimet në vitin 2020 ishin realizuar për 204% me ulët krahasuar me vitin 2018 dhe 139% më ulët krahasuar me vitin 2019. Realizimi më i ulët i shpenzimeve krahasuar me vitin 2019 ishte për shkak të shkurtimeve buxhetore të mëdha buxhetore, ngecjes së projekteve të financuara nga huamarrjet dhe klauzola e investimeve, ngecjeve të projekteve për shkaqe të problemeve pronësore dhe ndërprerjes së punimeve për një periudhë të caktuar me vendim të qeverisë për shkak të situatës së krijuar me pandemisë. Ml me buxhet të rishikuar, kishte planifikuar të financonte rreth 253 projekte kapitale në vitin 2020. Prej tyre 23 ishin projekte të reja, ndërsa për 98 projekte të cilat ishin planifikuar, nuk kishte fare realizim.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Në totalin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2020, investimet kapitale përbëjnë 84% të shpenzimeve, mallra dhe shërbimet 12.5%, pagat dhe mëditjet 2%, subvencionet dhe transferet 1.4% ndërsa komunalitë përbëjnë vetëm, 0.17% të shpenzimeve totale.

Sipas informimit lidhur me projeksionet e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror (2021-2023) të dorëzuar nga Ministria e Financave tek organizatat buxhetore , të hyrat e buxhetuara për MI për vitin 2020 janë 3,146,262€, ndërsa, realizimi është 2,952,109€. Këto të hyra janë të hyrat nga taksa për leje të vozitjes, licencat për afarizëm, taksat administrative, licencat për aktivitete individuale të lira, gjobat nga inspektorati e të tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	**3,781,507.00**	**3,146,262.00**	**2,952,108.53**	**3,555,556.53**	**2,805,709.96**
Të hyrat jo tatimore	3,781,507.00	3,146,262.00	2,952,108.53	3,514,989.86	2,805,709.96
Të hyrat tjera	0.00	0.00		40,566.67	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të Ministrisë së Infrastruktures ka rezultuar në 19 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Ministria gjithashtu ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, pesë rekomandime janë zbatuar, dy ishin adresuar pjesërisht, dy nuk aplikohen më, dhe 10 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën nr. 3.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Ndërtimi i rrugëve regjionale	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet e keqklasifikimeve, prezantimit të të dhënave te raportimi i ekzekutimit të buxhet si dhe shpalosjeve në PVF.	Ky rekomandim nuk ishte zbatuar. Ministria edhe në vitin 2020 kishte realizuar pagesa nga kode jo adekuate.Kjo çështje figuron vetëm tek theksimi i çështjes për të cilën nuk është dhenë rekomandim.	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Shpenzimet për shërbime kontraktuese tjera	Ministri duhet të siguroj se është kërkuar llogaridhënie duke identifikuar rastet e tilla dhe se janë marrë masa në vënien e kontrollit, duke rishikuar përbërjen e anëtarëve në NjZP, të cilat duhet të jenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara nga huadhënësi dhe të parandalojnë angazhimet e tilla në të ardhmen.	Ky rekomandim nuk ishte adresuar për të gjitha rastet e identifikuara. Për me tepër shih çështjen e ngritur në raport.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.	Nga muaji tetor 2020, këta të punësuar nënshkruajnë listat e vijimësisë në punë, megjithatë për të njëjtit institucioni nuk kishte përcaktuar objektiva të punës si dhe nuk kishte realizuar vlerësimet e rezultateve në punë.Sipas departamenteve përkatëse, këta të punësuar nuk ishin të ngarkuar me ndonjë punë ose aktivitet të caktuar.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore të sipër përmendura në lidhje me procedurat e rekrutimit dhe anulimin e konkursit, dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës për veprimet apo mos veprimet e tyre të nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.	Në vitin 2020 në ministrin e Infrastrukturës nuk ishte realizuar asnjë proces i rekrutimit, kësisoj nuk kemi vërejtur mangësi të tilla.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri të ndërmerr masa në shtimin e kontrollit në administratë, në mënyrë që të njoftohen zyrtarët përkatës rreth kryerjes së obligimit për mbylljen e avanseve me kohë, ashtu që të rritet përgjegjësia e zyrtarëve të cilët shfrytëzojnë avanse për udhëtime zyrtare.	Edhe në vitin 2020 kishte raste të vonesave në mbyllje të avanceve.	Nuk ka filluar zbatimi

6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri të siguroj se në rastet e kompensimeve të personelit, të ndiqet mënyra e rregullt e pagesës së shtesave, se shtesat janë buxhetuar në kategorinë e duhur, si dhe të shqyrtohen vendimet e marra dhe të sigurohet se Ministria ka ndërmarrë veprimet e duhura ligjore.	Me vendimin e datës 04.08.2020 kishte shfuqizuar të gjitha vendimet e mëparshme për themelimet e njësive zbatuese të projekteve. Me datë 26.08.2020 ministri themelon një njësi të përbashkët për menaxhimin e projekteve të financuara nga fondet e huamarrjes për të cilën paraprakisht ishte marrë aprovimi nga MF. Për anëtaret e kësaj njësie në bazë të këtij vendimi nuk parashihej pagesa shtesë	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj se janë marrë masa për qartësimin e ligjshmërisë së këtyre njësive, të rishikohen vendimet për themelimin e tyre si dhe të ndërmerren veprimet konkrete, duke shtuar kontrollin dhe ngritur nivelin e llogaridhënies në pajtim me kërkesat rregullative.	Me datë 21.08.2020, MF kishte dhënë miratimin për themelimin e njësisë për menaxhimin e projekteve(siç është cekur edhe tek rekomandimi A1).	I zbatuar

8.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj një rishikim të sistemit të kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin dhe procesimin e pagesave për NjZP-të, për të siguruar besueshmëri lidhur me shfrytëzimin e burimeve buxhetore, duke përfshirë edhe ato nga fondi i huamarrjes.	Nga pagesat e testuara në vitin 2020, përveç personave të angazhuar në njësinë "Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Magjistrale Prishtinë-Mitrovicë" ku me marrëveshje parashihej financimin e shërbimeve këshillëdhënëse, nuk kemi evidentuar pagesa nga fondi I huamarrjes për të angazhuarit në njësit tjera.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit, aprovimeve paraprake të marra nga ZKA dhe njësia kërkuese.	Raste të ngjashme kishin ndodhur edhe në vitin 2020, kësisoj ky rekomandim nuk ishte zbatuar nga ministria.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se obligimet kontraktuese krijohen vetëm brenda kufijve të ndarjeve vjetore të buxhetit. Në rastet kur kontratat janë shumëvjeçare, kjo të parashihet edhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve, dhe zotimi i fondeve të bëhet deri në shumat që planifikohet se do të jetë progresi i kontratave.	Nga mostrat e testuara në vitin 2020 nuk kemi identifikuar raste të hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme buxhetore.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.	Raste të njëjta janë identifikuar edhe në vitin 2020, kësisoj ky rekomandim nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Investimet kapitale	Ministri duhet sigurohet se pjesë e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, duhet të jenë të përfshirë edhe zyrtarë të ministrisë, apo siç parashihet me marrëveshjet përkatëse, për t'u siguruar se proceset e prokurimit zhvillohen në kuadër të një transparence të plotë dhe në pajtim me rregulloret, si dhe të informohet me dinamikën e projekteve.	Pjesëmarrja e anëtareve të ministrisë në komisione të hapjes dhe vlerësimit, nuk ishte kërkesë e memorandumeve të nënshkruara në vitin 2020.	I zbatuar

13.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe çertifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë, dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.	Raste të ngjashme kemi identifikuar edhe në vitin 2020, kësisoj ky rekomandim nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj mbikqyrje efektive të projekteve, në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim të plotë me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e ekzekutuara. Po ashtu, të siguroj se menaxherët e kontratave për çdo ndryshim në kushte të kontratës gjatë zbatimit të projektit, bëhet vetëm pas aprovimeve paraprake të marra nga njësia kërkuese dhe ZKA.	Ky rekomandim nuk ishte zbatuar, kjo sepse edhe në vitin 2020 kemi identifikuar raste të ndryshimeve të kushteve të kontratës pa aprovim nga ZKA dhe Zyra e Prokurimit.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se janë evituar shkaqet që ndikojnë në vonesa dhe mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive që do të mundësonin raportimin e drejtë të vlerës financiare të pasurive sipas kërkesave ligjore.	Komisioni i inventarizimit në vitin 2020 nuk kishte dorëzuar raport përkatës para përpilimit të pasqyrave.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se ekzistojnë kontrolle funksionale të cilat sigurojnë që regjistri i pasurive azhurnohet sipas klasifikimit të duhur duke reflektuar vlerën e saktë të prezantuar. Po ashtu, të sigurohet mbështetje e duhur në trajnimin e personelit të angazhuar në menaxhimin e pasurisë.	Në procesin e menaxhimit të pasurive kemi identifikuar disa mangësi edhe në vitin 2020. Kësisoj ky rekomandim nuk është adresuar.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave në inkasimin e këtyre pagesave dhe dhe të krijojë mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve nga debitorët.-	Edhe gjatë vitit 2020, kemi vërejtur që ministria nuk kishte ndërmarrë hapa konkret për inkasimin e borgjeve.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve.	Edhe në vitin 2020, kemi identifikuar raste kur nuk ishte bërë drejt shpalosja e obligimeve të papaguara.	Nuk ka filluar zbatimi

19.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rrit kontrollet lidhur me sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e faturave të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.	Vonesa në realizimin e pagesa kishin ndodhur edhe në vitin 2020.	Nuk ka filluar zbatimi

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Shpenzimet për shërbime kontraktuese tjera	Ministri duhet të siguroj llogaridhënie adekuate duke identifikuar rastet e angazhimit të personelit në NjZP pa aprovim paraprak nga huadhënësi. Po ashtu, të siguroj rishikimin e përbërjes së anëtarëve në NjZP, për të qenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara nga huadhënësi dhe të parandalojnë angazhimet e tilla në të ardhmen.
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të pasurive (sidomos vlerave të regjistruara të shpenzimeve të mirëmbajtjes) në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e identifikuara dhe të prezantohet saktë vlera e pasurive në RVF.
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive duke larguar automjetet të cilat nuk janë pronë e ministrisë dhe duke regjistruar ato të cilat janë në pronësi të saj.
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që regjistrit të pasurive t'i bëhet një rishikim i detajuar në mënyrë që të eliminohen mangësitë të cilat janë prezente në fushën e pasurive.
6.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e ministrisë janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive. Po ashtu, duhet të siguroj që vlera e stoqeve të prezantohet drejt në RVF.
7.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.
8.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.
9.	Baza për opinion	Ministri duhet te siguroj se me rastin e përgatitjes së RVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.
10.	Baza për opinion	Ministri të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar regjistrimin e saktë dhe të plotë të të gjitha pasurive kapitale në pajtim me kërkesat ligjore. Në një periudhë sa me të shpejtë, duhet të plotësohet pozita e zyrtarit të pasurive dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme.

11.	Baza për konkluzion	Ministri duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së dosjeve nga zyra e prokurimit, të ofrohen të gjitha informatat relevante për procedurën e cila do të aplikohet. Gjithashtu, zyra e prokurimit duhet të aplikoj llojin e procedurës për kontratë kornizë duke potencuar devijimin +/-30% në vlerën indikative të kontratës (në rastet kur mund të definohet sasia indikative), dhe vetëm në rastet kur sasia indikative nuk mund të definohet, atëherë të aplikohen kontrata me çmim njësi në formën që e parasheh ligji. Përpilimi i kontratave duhet të bëhet në mënyrë të atillë që të mos krijojnë konfuzion lidhur me vlerën dhe sasitë që duhen realizuar. Përveç kësaj, të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjanohen tejkalimet.
12.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurohet se projektet ekzekutive të hartohen në harmoni me gjendjen në terren. Inicimi i projekteve të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve për realizimin e procesit të shpronësimit. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.
13.	Baza për konkluzion	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të lidhura nga komunat për projektet që bashkë financohen me ministrinë, të kërkohet pëlqimi paraprak nga ministria siç është e paraparë me memorandumet e mirëkuptimit.
14.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të mundësoj realizimin e aktiviteteve të parapara me aktemërime për këta të punësuar bazuar në objektiva të qarta të përcaktuara paraprakisht nga ministria. Gjithashtu, duhet të bëhet monitorimi i tyre i vazhdueshëm, ashtu siç parashihet me aktet ligjore.
15.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve nuk i anashkalojnë kërkesat ligjore dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit ZKA.
16.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se janë duke funksionuar kontrollet në departamentin e prokurimit dhe kërkesat të cilat i drejtohen këtij departamenti nga zyrtarët e përfshirë në procese të ndryshime të prokurimit, të trajtohen me kujdes në mënyrë që të evitohen vonesat e paarsyeshme. Për më tepër, Ministri të sigurojë evitimin e ndryshimeve të shpeshta të stafit në këtë departament për shkak të ruajtjes së konsistencës dhe për të evituar bartjen e përgjegjësisë së gabimeve të ndodhura.
17.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që, kërkesat e ndryshme të palëve të treta të trajtohen në kohë sipas rregullativës ligjore në mënyrë që vendimet përkatëse të mos kenë implikim negativ në projektet e ministrisë. Tutje, duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke siguruar komunikim të mirëfilltë në mes të drejtorive kyçe dhe duke siguruar informim të saktë dhe në kohë të personave që janë përcaktuar në menaxhimin e projekteve të ministrisë. Ministri, duhet të sigurohet që rruga e dëmtuar të kthehet sa më shpejtë në gjendjen e mëparshme.
18.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurohet që kërkesat e tilla të palëve tjera të shqyrtohen në dakordim me rregullativën ligjore dhe realizimi i projekteve të bëhet vetëm pasi të aplikohen të gjitha procedurat e parapara me ligj.
19.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të gjej një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.
20.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar mbylljen e avanceve të hapura. Po ashtu, të merren masa konkrete që në të ardhmen zyrtarët të cilët marrin avance për udhëtime zyrtare t'i mbyllin ato me kohë dhe në përputhje me kërkesat e UA.
21.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar nëpajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

22.	Investimet kapitale	inistri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe certifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.
23.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe implementimin e projekteve për investime kapitale e në fokus të veçantë të jenë autoudhat si projekte madhore dhe komplekse në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore. Para inicimit të projekteve, ministria duhet paraprakisht të pajiset me leje ndërtimore për projektet e caktuara ku kësaj procedure i paraprinë edhe realizimi i shpronësimeve të cilat parashihen për realizimin e projekteve.
24.	Investimet kapitale	Ministri të sigurojë se projektet e iniciuara realizohen sipas marrëveshjeve kontraktuale përkatëse dhe në rastet e vonesave të paarsyeshme të merren masat që parashihen me këto marrëveshje. Po ashtu, Ministri të sigurojë se NjZP është duke kryer funksionin e saj në përputhje me qëllimin për të cilin është themeluar.
25.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që procedurat e përzgjedhjes së kompanisë mbikëqyrëse të realizohen në afat sa më të shkurtër kohor në mënyrë që të evitohen vonesat në realizimin e projekteve. Po ashtu, Ministri duhet të siguroj që planifikimi i buxhetit të bëhet në harmoni me kontratat e nënshkruara dhe planet dinamike të tyre.
26.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që zyra e prokurimit është duke mbikëqyrur zhvillimin e proceseve të prokurimit dhe realizimi i kontratave kryhet brenda kornizës ligjore. Në mënyrë specifike në rastet kur paraqiten vonesa në realizimin e projekteve, të sigurohet se janë vazhduar siguritë e ekzekutimit për ato projekte.
27.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në terren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.
28.	Investimet kapitale	Ministri të siguroj se nënshkrimi i kontratave nga zyra e prokurimit të bëhet në pajtueshmëri të plotë me afatet kohore të publikuara në njoftimin për kontratë.
29.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se është finalizuar procesi i inventarizimit dhe është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në mënyrë që të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive në RVF.
30.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave në inkasimin e këtyre pagesave dhe dhe të krijojë mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve nga debitorët.
31.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rishikoj mekanizmat e kontrollit në sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.
32.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.

Vlora Spanca, Auditor i Përgjithshëm



Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Florim Beqiri, Udhëheqës i Auditimit




Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit




Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit


Mjellma Dibra, Anëtare e ekipit



Laureta Matoshi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Kl. klasif. Klas. znak Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	147	1507	1

M-01 | 01 | 3068/21 | 05.08.21 | PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2020 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Data: 05/08/2021, Prishtinë.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[15] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.[16] . Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Projektet me Komunën e Istogut ishin Asfaltimi i rrugës Banj dhe Bainc (vlera 86,675€),Asfaltimi i rrugës Staradran dhe Ozdrim(201,404€),Asfaltimi i rrugës Dubrav(121,214€),Asfaltimi i rrugës Beellopoj dhe zhagovë (218,531€),Asfaltimi i rrugës Istog-Cerrcë(238,894€).Projektet e përfunduara në Komunen e Kacanikut ishin (Asfaltimi i rrugëve Lushi,Gerlicë (214,354€) në vitin 2019 dhe Asfaltimi i rrugëve në qytet (100,162€), në vitin 2020

[6] Ky gabim është korrigjuar në Pasqyrat e Konsoliduara të RBK-së, ndërsa në pasqyrat e ministrisë i njëjti gabim nuk ishte korrigjuar.

[7] [1] Kjo sepse nuk ishte njoftuar menaxheri i projektit nga ministria për dhënien e pëlqimit subjektit tjetër

[8] Vlen të ceket se gjatë testimeve tona kemi vërejtur se nga kodi i miërmbajtjes së urave, janë paguar edhe shërbimet e realizuara me dy kontrata tjera për riparim të urave, kjo do të thotë se mjetet e parapara në buxhet siç ishte cekur në nenin 24 të kontratës nuk ishin të buxhetuara vetëm për realizimin e kësaj kontratë. Vlerësimi i punëve të kryera(5,377,058€) ishte më e lart për 1,025,036€ krahasuar me vlerën e prezantuar.Tek kontratat "Sinjalizimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës" vlera e kontratave ishte - Lot 1 çmimi njësi 295.5€, Lot 4 çmimi njësi 287 ndërsa Lot 6 çmimi njësi 288.63€.

[9] Njësia e kërkesës kishte përpiluar sasitë indikativë vjetore ndërsa zyra e prokurimit në dosjen e tenderit kishte prezantuar të njëjtë sasi për periudhën dy ose tri vjeçare. Tutje, vlera e parashikuar vjetore e këtyre kontratave, në doje të tenderit ishte prezantuar si vlera e parashikuar e komplet projektit.

[10] Bazuar në pranimin teknik të pjeseshem të realizuar me datë 19.12.2019

[11] - Kryesisht tek punët e zhavorrit,betonimit,armimit,vendosjes se gvpave etj - Nuk ishte realizuar pozicioni “Furnizimi dhe punimi i asfaltit binder 0-16S mm me trashësi t=4cm ne gjendje te ngjeshur” me cmim të kontraktuar 4.48€ ndersa është realizuar pozicioni “Furnizimi dhe punimi i asfaltit binder 0-16S mm me trashësi t=6cm ne gjendje te ngjeshur” me cmim 6,72 € i cili çmim nuk ishte paraprë në kontratë

[12] Si njësi është e emëruar për të kordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për projektin.Përveq sigurimit të licencave shtetërore dhe të drejten e përdorimit të rrugëve MI ka qenë e obliguar që deri me 31 Mars 2018 të emëroj konsulentë me reputacion në përputhje me termat e referencës të pranueshme për Bankën, deri me 31 Mars 2019, të miratojë rekomandimet e financimit të sektorit rrugorë dhe studimin institucional të përgatitur nga konsulentë ndërkombëtarë. Duke filluar nga 1 Janari 2019 të përgatisë një program trevjeçar të mirëmbajtjes dhe investimeve për rrugët shtetërore, deri me 31 qershor 2018, të përfundojë inspektimin e sigurisë rrugore dhe vlersimin e rrjetit rrugor kryesor, deri në 31 dhjetor 2018 të miratojë legjislacionin sekondar dhe të themelojë Agjencinë lëshuese dhe procedurat për trajnimin dhe certifikimin e auditorve të sigurisë rrugore; deri më 31 dhjetor 2019 të sigurohet se së paku 5 auditorë të sigurisë rrugore janë certifikuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të Republikes së Kosovës

[13] Realizimi i këtij projekti mundëson ngritjen e Aeroportit Adem Jashari në kategorinë 3B, si nder kategoritë më të larta të Aeroporteve në mbarë botën e cila mundëson aterim edhe për fluturaket me pesha te rënda.

[14] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[15] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[16] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.